


HEJZA



Bashkim HOXHA

TEATRI SHQIPTAR PA IDENTITETIN E VET

AMBIGUITETI MORAL I LUCIFERIT

A ekziston ndonjë pushtet, ndonjë hero antipushtet, ndonjë "figurë perëndie" që mund të na tregojë se ku është kufiri midis të drejtave të shqiptarëve dhe të drejtave të maqedonaseve që janë identike si tonat! Para së gjithash, ky kufi nuk mund të gjendet nëse mungojnë njohurit mbi të drejtat e individit dhe të etnosit të tij. Ky angazhim për njohuri të tilla zvetënohet në çastin kur brenda qenies së luftëtarit për më shumë të drejtat futet Asjevi "me përmasa të Luciferit"

Nga Avni HALIMI

Pikat e larta e të fortifikuara prej nga, zakonisht, si në pëllëmbë të dorës shihen vendbanimet e dendur, vizitorëve gjithnjë ua ngacmojnë lakminë, atë dëshirë egoiste, e cila, shikuar nga këndi psikologjik, do të mund të quhej "fortesë e karakterit të vërtetë" e ngritur nën hijen e personalitetit të qdo individi. Në të tilla pika, turistët, udhëtarët e rastit, ata që ngjiten duke u përgjakur stepave e duke rrakullisur ndonjë gurë drejt lumit ku mund të ketë zënë fill të mbarë jetë, sakaq i përshtkon një ndjenjë e triumfalistik, pastaj një ndjenjë e perandorit, e shpëtimtarit të miletit nga e keqja. Nën këtë përsiatje impresioniste, shpërthenjë pastaj ato èndrra që janë emblemë e atyre karaktereve të ndrydhur nën peshën e frikës së brumosur jo me parime por me dobësi morale. Njëri turist do të shajë Zot e gurë që nuk është mbret i fortës. Tjetri turist vetëtimihi do ta ndjejë veten si hajn i pakapshëm nga xhandarmëria dhe i rrethuar nga bashkëveprimtarët e vet të cilëve do t'u jepte përqindje nga thesari i vjedhur. Turisti i tretë do të fillojë ta lakmojë fortësën si një vend ku do të ngjesheshin të gjitha idetë revolucionare, planet e sulmeve dhe projektet për ardhmëri. Gjithnjë të ndodhur përballë apo brenda fortësave shprehët një dëshirë që është e përbashkët për të gjithë soditësit "e rastit". Të gjithë do të kishin dashur të ishin pronarë të fortës me rend e rregulla, me parime e kode, me kanune e ligje që do të siguronin mirëqenie ekskluzivisht për mbretin dhe oborrin e tij. Vështruar nën thjerrën morale, këtu në të gjitha rastet kemi të bëjmë me lakminë e pushtimit, qoftë me të mirë, me kryengritje apo edhe me luftë.

Pse bëhen revolucionet

Lajtmotive të kësaj natyre hasen në letërsitë e shumë popujve, personazhet e këtyre kredove janë bërë frysëzim për shumë shkrimitarë botërorë. Pa dyshim, karaktere të këtillë, të transformuara nga qeniet psikosociale në qenje politike, në krijimtarinë e mëvonshme janë zbritur nga malet dhe fortësat, në rrafsh, në vende të hapura dhe në vendë urbane, aty ku ndërthurja e intrigave është shumë më dinamike ndërsa zërthimi i tyre është pothuajse i pamundshëm. Një karakter të tillë kishte edhe një figurë që këtu do ta përdorim si hero metaforik të cilin Encensbergeri në esenë e vet e quan "personazhi me përmasa të Luciferit"! Jevgeni Filipoviç Asjevi! Figura më kontroverse ruse e njohur që nga themelimi i Partisë Revolucionare Ruse më vitin 1900.

Georgi Plehanov, themelues i shkollës marksiste, ishte mbrojtës i paepur i mendimit se të gjithë revolucionet bëhen ose "rastësish" ose me "komplotë". Dhe këto revolucionë në esencë të synimit kanë marrjen e pushtetit. Nën motivin e një "synimi human", në emër të lirisë e të të drejtave më të mëdha, në fakt synohet pushteti. Frytet e para të "revolucionit" gjithnjë mbrohen nga soji i heroit Asjev!

Në esenë e vet "Shpirrat engjëllorë të terrorit", Encensbergeri shkruan se Asjevi fillimi ishte shef operativ i Organiza-



tës Luftarake, nga e cila doli Partia Socialiste Revolucionare e Rusisë. Gati asnjë nga revolucionarët nuk e dinin se Asjevi që nga viti 1892 ishte i rekrutuar si bashkëpunëtor i policiës cariste. Ishte kohë kur bolshevikkët ("shumica") po rrezikoheshin nga veprimet politike nacionaliste të menshevikkëve ("pakinës"). Asjevi, si prijës i një formacioni luftarak, kishte bindur partinë e vet se do të bashkëpunonte me policinë, me qëllim që sa spinjonte qeverinë, ndërkohë që qeverisë i ofronte informacione të plota e të shumta rrëth revolucionarëve. Pra, duke "i shërbyer" Organizatës, në fakt vepronte në dobi të qeverisë me qëllim që sa më shumë ta shkatërronte Organizatën. Ambiguiteti moral ishte arma më e fortë e tij që po e mbante në fronin partiak. Carit i shërbente duke e tradhtuar Organizatën e vet deri në shkatërrim, ndërkohë që i kënaqte edhe miqtë e vet me informacione që u sillte nga "armiqte", qeveria.

Pse Asjevi e kishte synim shkatërrimin e Organizatës! A ishte i stërvodhur nga veprimi "në ilegalitet". A frikësohej se një ditë kur do të bëhej kryeqeveritar do të mund të eliminohej pikërisht nga revolucionarët e vet? A i ishte kthyer lojalitetit absolut përballë Carit, i cili në shenjë falenderimi ia shpaloste të gjitha sekretet? Jo, përmasat e Luciferit te Asjevi kufizoheshin me synimet e tij të dyfishta: të dobësohej sa më shumë Qeveria, me qëllim që të shtohej nevoja qeveritare për angazhimin e tij deri në nivelin e shpëtimtarit dhe, meqë e ndjente vdekjen si nga qeveritarët ashtu edhe prej shokëve të vet, punonë në drejtë të shkatërrimit të Organizatës me qëllim që kontributi i tij prej lideri të vërtetë një ditë të ngruhej në nivele të legjendës. Veprimi politiko-skizmatik i tij bazohej në konceptin raskolnian. Sa më shumë "raskol", përcarje, sa më shumë të atomizohej qeveria dhe Organizata, aq më tepër do ta ndjente veten Zot i tyre (Një thoshte se kjo është ajo shpalosje e vullnetit të pakufishëm për pushtet). Asjevi ishte i bindur se është reformist i sistemit totalitar; mendonte se është ai të cilët i lejohet të bëjë gjithçka, madje, nën këtë inerci veprimi, kreu sërë atentatesh, duke likuiduar njëz të mëdhenj por edhe bashkëluftëtarë të tij prej të cilëve shihë rrezik!

"Zoti" që e sfidon edhe vdekjen

Kësijoj, sot, ky personazh kaq satanik, mund të haset pothuajse në të gjitha

shoqëritë e botës, duke bërë një jetë si dyfytyrësh. Haset sidomos në ato shoqëri multiplike si dhe në ato që janë në përpjekje e sipër për të ngritur sisteme shoqërore postkonflikuale. Madje, fatkeqësisht dalin ekskluzivisht nga revolucionarët, të cilët, duke u kyçur në pushtet, me qëllim të dëshmimit të pafajësimit për përmbytje të sistemit, me qëllim të dëshmimit të lojalitetit të paluhatshëm, nisin e nga radhët e veta nxjerrin Asjeva! Kjo metamorfozë etike haset në ato shoqëri ku bolshevizmi edhe përkundër përfjetimit të revolucionit mbetet edhe më tej të qeverisë me vendin. Ndërsa në ato shoqëri ku në qeverisje vijnë revolucionarët ndërkohë që bolshevikkët nënshtron, figura e Asjevit del me po të njëjtat përmasa dhe me po të njëjtin ambiguitet synimi. Synohet të disiplinohet anëtarësia madje deri në shkatërrim total të organizatës, me qëllim që frika të mbillet ndër popull dhe për pasojë të lind figura autokrate që nuk ka nevojë për organizata por për sklevrë.

Së këndejmi, janë plotësish në të drejtë antropologët kur vlerësojnë se kalimi i një pushteti nga duart e auto-kratëve në duart e revolucionarëve nuk sjell asgjë në favor të lirisë. Sepse, konflikti në mes i thitarëve të auto-kracisë dhe revolucionarëve kurrë nuk mund të përfundojë, ndonëse mund të ndjehet heshtja e përkohshme e konflikteve në mes të dy palëve. Benxhamen Konstani, përmes disa pyetjeve, me të drejtë ngrit një dilemë shumë të madhe që kërkon reflektim real. Ai pyet: ku është ndryshimi për individin nëse shtypet nga një diktator, nga një monark, nga pushteti i popullit apo nga një grumbull ligjesh jo humane. Pa dyshim, të gjitha pushtetet e ngritura nga revolucionet, nën synimin e krijimit të harmonisë shoqërore, gjithnjë e mendojnë shtypjen sa më të madhe të individit, atrofizimin total të idesë së tij se në pushtet mund të vihet me revolucion! Është ndjenja e frikës së rënies "me hile" nga pushteti. Prandaj ngadalë merret pushteti, duke u thyer fuqishëm të gjithë revolucionarët. Me këtë akt asjevistët dëshirojnë ta ngushëllojnë veten se janë mbi gjithçka, janë vete "zoti" që i bëjnë sfidë edhe vdekjes.

As eseisti Encensberger dhe as teoricienët e politikës nuk arritën ta deshifronin deri në fund misterin e veprimit të Asjevit. As sjelljet e tij, as qëllimi i jetës së tij, por as të gjitha

veprimet e tij nuk kishin pasur objektiva të shpjegueshëm politikisht. Ai, thjesht, përfkufizohet si "qenie me përmasa të Luciferit".

Kufiri midis dy të drejtave identike

Asnjë shoqëri, pra, as shoqëria jonë nuk është imune nga qeniet e këtilla. Ata i vërejmë gjithkund dhe, nën areolën e revolucionit, seç na duken si tipa karizmatik që mbajnë vulën e të shenjtët kombëtar. Për këtë shkak dhe kurrë nuk futen në laboratoriumin e zberthimeve të elementeve të tyre njerëzore. Mbeten të "shenjtë" sepse nuk kanë asgjë të lexueshme nga njerëzorja! Në fakt, vetëm pasi t'ju lexohen qëllimet dhe veprimet satanike tek atëherë mund të kuptohet ndonjë gjë nga realiteti i tyre njerëzor. Cili është ai realitet? Të jetuarit për pushtet, shkelje mbi sistemin e vlerave të kodifikuara më parë, me pretekst të ngrites së vlerave të reja, pavarësisht se ato, pa një bazë paraprake mund të pezullojnë në ajër si filluska dëbore që sapo të prekin tokën shkrihen. Asjevat e sotshëm shëmbëllejnë në subjekte të humbur të cilët, duke mos arritur që diku pas derës t'i gjejnë koordinatat e vendit të vet, jo vetëm që e degjenerojnë dhe e kriminalizojnë shoqërinë por edhe, gjithnjë e më shumë, i shtresojnë motivet e një promiskuiti dhe të një konflikti brenda kruzhokut të tyre. Si rrjedhojë e kësaj, liria nis e bëhet diçka e urryer. Në vend të respektimit ndaj aktit revolucionar, nis e shprehë nostalgjia për të kaluarën e errët. Në robëri kërkohet mbrojtja nga Asjevi i dehur nga liria.

Historia dëshmon se gjithnjë pas revolucioneve në pushtet vijnë revolucionarët. Në fakt, vetë masa e akumuluar e vullnetit për pushtet, shkakton konfliktin për marrje të pushtetit. Pasi të merret pushteti, prijësi i luftëtarëve për "më shumë të drejtë" që garantonin nga pozita e të qenët pushtet, zgjeron kufijtë e të ushtruarit të pushtetit, pa hetuar se rrëshqet drejt totalitarizmit. Liria dhe të drejtat e individëve dozohen gjithnjë sipas dëshirës dhe vullnetit të pushtetit. Secili pushtet ngritet dhe funksionon mbi themelat e kufirit në mes të mundshmes dhe të pamundshmes, reales dhe ireales. Vërtet a ekziston ndonjë pushtet, ndonjë hero antipushtet, ndonjë "figurë perëndie" që mund të na tregojë se ku është kufiri midis të drejtave të shqiptarëve dhe të drejtave të maqedonaseve që janë identike si tonat! Para së gjithash, ky kufi nuk mund të gjendet nëse mungojnë njohurit mbi të drejtat e individit dhe të etnosit të tij. Ky sens për njohuri të tilla zvetënohet në çastin kur brenda qenies së luftëtarit për më shumë të drejtat futet Asjevi me përmasa të Luciferit.

Në kohën e Asjevit, caristët kishin përdorur shumë shpesh shprehjen popullore "Në secilin rus të gërvishur del një moskovit"! Ndërsa revolucionarët kishin përdorur shprehjen e tyre, "Në secilin revolucionar të gërvishur del një Asjev"! A mund të jetë morali i këtyre frazave shprehja "Në secilin popull të gërvishur del robëria"?

Pasionantë dhe profesionistë

NJË PLEJADË E RE PËRKTHYESISH

Sokol Çunga është një nga ata që po hyn me hapa të matur e të sigurt në universin gjithnjë të debatueshëm e shpesh të shpërdoruar të përkthimeve. Kujdesi, përzgjedhja dhe puna që bën me gjuhën, më shtyjnë të mendoj se ai ka hyrë për të mbetur gjatë aty

Dashnor KOKONOZI

Përpiqem të gjej nëse ka edhe të tjerë që e kanë pëlqyer po aq sa unë Antologjinë pale-tine, të përkthyer nga Sokol Çunga dhe nuk gjej. Dua të shpresoj se ka, por nuk po i gjej unë. Se po të qe e kundërtë, vërtetat kjo mos-njeshmëri do të qe një problem serioz për të gjithë.


Kujtoj se një gjë e tillë më kishte ndodhur edhe me universin e përkthimeve të Bajram Karabollit (se ka edhe përkthyes që krijojnë universin e autorëve të tyre, në të cilin perfektionohen. Por ndjeshmërinë më të madhe ndaj punës së tij kolosale shoh se e shprehin lexuesit e thjeshtë e të shumtë, nuk kam gjetur analiza mirëfshi profesioniste).

Antologjia Palatine - Epigramet erotike meriton të jetë një "platformë e mirë reflektimi" për përkthimet në gjuhën shqipe. Ka lëvizje, drejt perfeksionit erudit.

Ka edhe përkthyes jo të pakët, që nga koha në kohë botojnë në llogaritë e tyre autorë të ndryshëm, shpesh me cilësi të habitshme, si Keti Dibra, Eda Merepeza etj., por nuk flas për to, se më duket se ende janë në fazë testimi të vetes dhe të shijeve të lexuesve.

Sokol Çunga është një nga ata që po hyn me hapa të matur e të sigurt në universin gjithnjë të debatueshëm e shpesh të shpërdoruar të përkthimeve. Kujdesi, përzgjedhja dhe puna që bën me gjuhën, më shtyjnë të mendoj se ai ka hyrë për të mbetur gjatë aty.

Bashkë me të shoh edhe Eleana Ziakou-n,



Aida Baron, Arben Deden e ndonjë tjetër, pa folur për poezinë tradicionale kineze të përkthyer nga Dan Tuzi që vijnë menjëherë pas një plejade përkthyesish të tjerë të afirmuar, si Idlir Azizi, Romeo Çollaku, Gentian Çoçoli etj.

Më tërheqin shpesh edhe përkthimet poetike të Alfred Kolës.

Ka shenja të dukshme se jemi në kapercyell të një evoluimi më profesional të përkthimeve në gjuhën shqipe.

Në një farë mënyrë këta përbëjnë një pol të rëndësishëm të gjeneratës së re të "shkollës së përkthyesve shqiptarë". Se vërtet, rolin i përkthyesve në gjuhën shqipe unë nuk e shoh të ngjashëm me asnjë nga ato të vendeve të tjera me letërsi të konsoliduar dhe gjuhë "natyralisht standardizuar" prej shekujsh.

Përkthyesit shqiptarë kanë qenë formues të kulturës së brezave të rinj, sa kohë që letërsia vendase më fort i ka tërhequr pas se sa i ka shtyrë përpara. Në shqip, gjuha e përkthyesve gjithnjë ka tingëlluar me e bukur dhe më e pasur se ajo e shkrimitarëve vendas. Kombet e mëdhenj gjithnjë kanë qenë të vetëmjaftueshëm me artin e tyre, ne do të ishim të gjymtë pa artin e të tjerëve.

Ky evoluim i kësaj gjenerate të re duhej t'u kishte rënë në sy që më parë atyre që merren në këtë punë. Ka lëvizje sikundër edhe pikëllim të madh cilësor, po ndodh rrallë here që ne të marrim guximin t'i cilësojmë me emrin e tyre të vërtetë fenomenet që ndeshim.

Se pika e ujtit e tregon guximin e saj duke rënë në shkretëtirë!

Pikëpamje

AKADEMITË E ARTEVE PRODHOJNË NUMRA...

Dikur një vepër arti ka shërbyer sikur një lloj portal i për një sferë më të thellë të mendjes. Ndërsa tani dominojnë pseudo-artistët



Burhan AHMETI

Shpeshherë më duket sikur bëj një luftë me veten për të mos e ndjerë se jam në një luftë të përditshme për të mos u bërë i cekët si krijues figurativ. Një mik-armik i yni është teknologjia, e cila po na e zgjelën hapësirën e vëmendjes dhe na e mbush ditën me shpërqendrime të shumta joshëse. Armiku tjetër i dytë i shoqërisë tonë shqiptare dhe komunitetit të artistëve

është politizimi i gjithçkaje. Shumica e njëzëve të profesioneve të ndryshme si: mjekë, juristë, ekonomistë, gjithashtu edhe shumë artistë po e kalojnë kohën e tyre duke u përfshirë në politikë, duke u marr me rivalitetet e parashikueshme partiakë, analizatë fushatave dhe gjithçkaje tjetër që s'ka të bëjë me art.Pra, duket sikur më joshëse, më fitimprurëse për ta është politika, ngaqë më shpejtë mund të bëhen me famë dhe më shpejtë mund t'i mbulojnë dobësitë dhe zbrazëtirat profesionale që i kanë. Arti është një lloj vitamine jo e rëndësishme, por më se e domosdoshme për të gjithë shoqërinë tonë.

Fatkeqësish, arti është marr peng nga mediokriteti. Akademitë e arteve prodhojnë numra, jo vlera. Artistët e talentuar e kanë lënë anësh èndrrën për karrierë artistike dhe merren nevojat e tyre bazike. Mendoj se të gjithë ne duhet të përpinqemi dhe të marrim kundërmasa. Të kalojmë në profesionin tonë, të vazhdojmë të merremi me art, ndërsa politikanët le të merren me politikë.

Artistët në përgjithësi përmes artit të tyre nuk synojnë t'i përmirësojnë tjerët, ata thjesht duan që me potencialin e tyre krijues t'i qetësojnë shikuesit bashkë me zërin e egos së

tyre. Fatkeqësish, ne si popull e kemi humbur veten duke lexuar një libër, duke dëgjuar një këngë, duke shikuar një shfaqje, gjithashtu i kemi humbur gjurmët e hapësirës dhe kohës. Dikur një vepër arti ka shërbyer sikur një lloj portal i për një sferë më të thellë të mendjes. Ndërsa tani dominojnë pseudo-artistët, duke iu treguar të tjerëve se dinë të bëjnë art dhe duke i bindur për shkarravina e tyre se janë art.

Madhështia e një vepre arti me bukurinë e vlerën që ka, na shtyn t'i kushtojmë një lloj vëmendjeje tjetër. Na befason dhe na shtyn të heqim dorë nga prirja egoiste për të imponuar gjithmonë mendimet tona mbi gjësëndet. Arti i mirëfilltë na ofron një ndryshim të rregullave të lojës, duke na mundësuar të mendojmë për çështje të përbashkëta shoqërore pa u thirrur në kundërshtimin poshtërues midis atyre që kanë të drejtë dhe atyre që mendojnë ndryshe. Vizita e një ekspozite arti me vlerë na e zgjeron repertorin tonë emocional. Këto lloj vizita dhe përvaja na jepin një lloj njohurie emocionale - si të ndihemi dhe si të shprehim ndjenjat, si të simpatizojmë dikë që është në pikëllim, si të ndajmë kënaqësinë me të tjerët etj. Ekspozitat, shfaqjet apo

librat na mësojnë se si ta shohim botën me sytë dhe mendjen e një tjetri, shpesh të një personi që sheh dhe mendon më thellë se ne.

Jetojmë në një epokë politike dhe teknologjike, ku artet janë bërë shumë pak të rëndësishme në jetën e përditshme publike. Mendoj se shkaku është se ne nuk debatojmë për romane dhe krijime artistike siç bënin njerëzit në kohët e dikurshme. Tani më vetë bota artistike është turbulluar nga mendimi i grupimeve apo klaneve të izoluara dhe kjo ka kontribuar në dehumanizimin e kulturës tonë. Nuk është vonë për të hequr dorë nga varësitetona politike herë pas here dhe të shijojmë lojën e lirë të mendjes, shpirtin jodogmatik dhe gjendjet e ngritura dhe të adrenalinuara të ndërgjegjësimit që arti i mirëfilltë ka çka na ofron. Demokracia në Maqedoninë e Veriut sikur ka hy në një krizë të veçantë, por edhe heshtja e intelektualëve, polarizimi, brutaliteti i diskursit publik, përhapja e dezinformative i ka futur artet akoma më shumë në krizë. Këtë gjendje mendoj se mund ta ndryshojmë bashkërisht me vepra, fakte, paanshmëri dhe objektivitet. Të krijojmë sa më shumë art, t'i edukojmë dhe përkrahim brezat e ardhshëm.

Intervistë: Bashkim Hoxha, prozator, dramaturg, skenarist...

TEATRI SHQIPTAR PA IDENTITETIN E VET

Regjisori e tanë e kanë vështrimin diku tjetër, larg shumë larg. Kanë zbuluar një grumbull komedish të fund viteve gjashtëdhjetë kur në Europë ndodhë revolucioni seksual dhe në skenë ngjiten herë gra që tradhtojnë, herë burra që tradhtojnë, herë burri tenton të vrasë gruan, herë dashnori tenton të vrasë bashkëshortin e dashnores e histori të tilla të lehta që kanë situata humor, por pak, shumë pak art, dhe akoma më pak mundësi për të krijuar një identitet kombëtar

Intervistoi: Avni HALIMI

Bashkim Hoxha është nga krijuesit tanë më produktiv. Opusi i tij krijues është i gjerrë dhe përfshin romane, drama, skenarë etj. Ndërsa tjetra, ka botuar romanet: "Gruaja e shit", "Kronikat e mjegullës", "Duartokës", "Një ditë si Skënderbeu", "Një shaka e vogël me vdekjen", "Asnjëherë të martën" etj. Pastaj dramat: "Shokë luftë", "Vërsime pranverore", "Të jesh 20 vjeç", "Pranvera që s'vonoi", "Lajme të vonuara nga ura e Qabesë", "Unë dhe Mefistofeli" (Çmimi A. Moisiu 1988), "Këngë dashurie me korbo" (Çmimi A. Moisiu 1997), "Qyteti pa dashuri", "Në të gjithë kënduam Margaritinë" (Ftesë për gjyq), "Askushi", "Udhëtimi pa vizë i një alieni", "Grepri i artë", "Hotel Ballkan". Autorësinë e tij mbajnë edhe skenarët: "Në çdo stinë", "Një vonesë e vogël", "Plumba perandorit", "Vals i ngrirë në Prishtinë", "Këtu vallëzohet me hijet" etj. Me Bashkim Hoxhën bisedojmë kryesisht për dramën dhe teatrin shqiptar.

HEJZA: Historikisht, drama është shkrurar duke u bazuar në ngjarje të kohës, përti madhëruar fenomenet, por edhe përti luftuar dukuritë! Kjo "lindi" katarsisin! Forma dhe mënyra e arritjes së katarsisit ka bërë që motivet dhe temat e ndryshme të përfshihen në shumë repertorë të teatrove botërorë. Teatrot tonë kombëtare, meqenëse shumë më tepër parapëlqejnë katarsisin që vjen nga motivet e huaja se sa këtë shpëlarje shpirtërore të arrijnë duke trajtuar tema origjinale, nga historia, folklori, mitologjia, por edhe nga e përditshmja joni, sikur kanë ngelur pa identitet kohëve të fundit! A kemi teatër shqiptar sot, jo si objekt por si art?

B. HOXHA: Më vjen mirë që bisedën për dramaturjinë e filloni me një pëershkrim të gjendjes së teatrit. Shpesh herë thuhet se dramaturgia shqipe është në krije, por në të vërtetë dramaturgia shqipe e vënë në skenë reflekton krisjen e vet teatrit. Teatri shqiptar ndodhet në një kryqëzim rrash, këndvështrimesh, stilesh ende pa përcaktuar identitetin e vet në shekullin XXI. Për fat të keq, identitetin e tij të ri, ky teatër nuk është duke e kërkuar te dramaturgia, tradita, mitologjia shqipe apo ato vlera që përbëjnë fondin themeltar të vlerave të papërsëritshme, por e kërkon diku larg në gjegjësi dhe në kohë. Edhe kur e kërkon të krijojë personalitetin e vet përmes dramave themelte të dramaturjisë botërore, regjisori e sotëm rendin kryesisht në komeditë e lehta britanike apo franceze që vet ata i quajnë bulevardeske, komerciale ose në rastin më të mirë, farsa. Stili i preferuar i mjaft regjisoreve mbetet teatri alternativ i vitezë gjashtëdhjetë i shekullit të kaluar. Gjëra të kaluara. Tipike është fragmentarizimi i tekstit, shkurtimet, madje më keq, përshtatja e dialogëve me terma gazetareske të ditës. E kanë pësuar edhe klasikët edhe modernët. Për shembull, një regjisori dramës Equis që sjell mesazhe të thella njerëzore, analizon instinktin, i shton një monolog të shkruar nga njeri prej aktorëve për vetingun e gjyqtarëve (fenomen i ditës në atë kohë në Shqipëri). Dhe kjo nuk është anekdotë. Kjo ka ndhur në skenën e Teatrit Kombëtar. Preferohet performanca që i lë në hipe tekstet e mrekullueshme të dramaturgëve të



mëdhenj dhe spektaklet kanë shumë vrapime nëpër skenë, koreografi moderne, plastikë aktoriale dhe aspak përqendrim në filozofinë e tekstit që i jep rëndesën këtij zharrin, as që bëhet fjalë të mbërrihet tek katarsis. Dramaturgu i shquar shqiptar, Minush Jero, e quante dramën artilleri e rëndë e shkrimitarë. Tani kjo artilleri është e haruar në kazerma së shtëpia e dashurit që i ka hequr rëndesën vet teatrit dhe nuk i fiton dot e vëtrne betejat. Kur tekstet kanë marrë rëndesën e duhur, spektatori i ka mirepritur edhe klasikët, por edhe dramat shqipe. Një përvjoje e suksesshme ishte vënia në skenë e Pas vdekjes e Çajupit nga Hervin Culi, Gorani i Baba Tasit të Fishtës nga Altin Basha, Kush e solli Doruntinë e Kadaresë nga Laert Vasili, Kandili i Argjentë i Carnajt nga Fatbardh Smaja, Nusja në thes e Zhitit nga Elma Doresi etj.

HEJZA: A mund të ngritët identiteti i teatrit tonë duke e mbështjellë me tradita, mentalitet, histori e ngjarje të huaja? Cilat tema shqiptare do të ishin në fokusin e politikave të teatrove të huaj!

B. HOXHA: Ju me të drejtë e hidhni vështrimin në preferencat e të huajve për dramën shqipe që nuk kanë munguar. Ata kanë preferuar dramën shqipe përtatë tretur si pjesë e universalitetit në identitetin e teatrit të tyre. Jeton Neziraj mund të flasë më mirë përsesësin e dramave të tij nëpër teatro të huaja, përzgjedhur pikërisht sepse sjellin identitetin shqiptar dhe ballkanas. Allegroto Albania u preferua për vlerat dramaturgjike dhe për identitetin e saj kombëtar, komedia TAG u përzgjodh për lexim në festivalin më të madh european të teatrit në Sibiu të

Rumanisë për temën e saj universale, por edhe për identitetin shqiptar të personazheve dhe të peizazhit ku zhvillohen ngjarjet. Të huajt e shikojnë identitetin shqiptar në dramat që përzgjedhin, regjisori tanë e kanë vështrimin diku tjetër, larg shumë larg. Kanë zbuluar një grumbull komedish të fund viteve gjashtëdhjetë kur në Europë ndodhë revolucioni seksual dhe në skenë ngjiten herë gra që tradhtojnë, herë burra që tradhtojnë, herë burri tenton të vrasë gruan, herë dashnori tenton të vrasë bashkëshortin e dashnores e histori të tilla të lehta që kanë situata humor, por pak, shumë pak art, dhe akoma më pak mundësi përtë krijuar një identitet kombëtar. Politikat e repertorit tek ne nuk e favorizojnë përpjekjen e ndershme përtë krijuar identitetin tonë në teatër dhe përtë hyrë denjësisht në familjen e madhe botërore të teatrit. Duhen vizione të qarta, harta të sakta ku shkel përtë bërë hulumtimet serioze ne realizimin e kësaj detyre të madhe. Nuk e kemi këtë vëmendje dhe synim. Jemi peng i rastësisë dhe kulturës fragmentare të krijuarve dhe politikanëve tanë.

HEJZA: Politikat shtetërore, politikat e teatrove kombëtare, më tepër dëshmojnë për një injorim të teatrit kombëtar (si nocion eseistik) se sa për një përkushtim përtë shpëtuar nga pluhuri i madh atë pak identitet të teatrit kombëtar!

B. HOXHA: Në platformat e çdo qeverie, në platformat e çdo drejtuesi kur merr emërimin, fjala identitet kombëtar përmendet shpesh. Në praktikë nuk bëjmë asgjë. Në shtypin tonë ka një debat të hapur lidhur me identitetin e polifonisë labë të vënë në mbro-

jtje nga UNESCO. Një palë argumenton se kanë diçka nga koret bizantine. Një pale tjetër thonë se është ngushtësisht e traditës shqiptare. Askujt nuk i shkon ndërsa mend se këngët polifonike mund të janë edhe rudiment i teatrit antik, me protagonist, antagonist dhe kor. Mund të mos jetë edhe kjo e saktë, por e sjell në vëmendje përtë thënë se ne as që e mendojmë se kemi traditë teatrose antike, edhe pse kemi shumë teatro të vjetër në zona të ndryshme të vendit. Ka më se dy shekuq që shkruhet dramaturgji shqiptare, ka mendime të ndryshme se cila është drama e parë, Besa apo Ermira, apo ndonjë tjetër, por kemi vëtë këtë garë kohe dhe në repertorët e teatrove kombëtare ne nuk e kemi asnjë prej dramave të para shqipe, sigurisht me vështrime bashkëko-hore, siç veprohet me dramat antike greke apo me pjesët klasike të fondit botëror.

HEJZA: Ju jeni një nga dramaturgët më formë aktualisht. Ç'mund të na thoni rrëth bashkëpunimit të teatrove të qyteteve dhe atij kombëtar me dramaturgët?

B. HOXHA: Bashkëpunimi i teatrove me dramaturgët fillon vetëm atëherë kur projekti është përzgjedhur përtë u vënë në skenë. Para shtatë vjetësh një drama ime, Askushi, fitoi në Prishtinë çmimin e parë Katarina Josipi. Sipas kushteve paraprake të konkurrimit çmimi i parë do të vihej në skenë nga Teatri Kombëtar në Prishtinë. Kanë kaluar shtatë vjet dhe kjo nuk ka ndodhur. Nuk ka ndodhur as botimi, as përkthimi në një gjuhë të huaj, siç parathuhej në ftesën zyrtare për konkurrim. Ndodhi me keq. Një vit më pas, pra gjashtë vjet më parë, u vu kushti kufizues që në këtë konkurs të dramës shqipe mund të marrin pjesë vetëm shtetas



të Kosovës dhe asnjë tjetër nga përtej Drinit. Në vend të unifikojmë përpjekjet tona përmes identitetin shqiptar të teatrit, ne myllim dyert. Absurde. Vazhdojmë më tej. Teatrot funksionojnë me projekte të paraqitura nga regjisoriët dhe gjithçka është lënë në preferencën e nivelin e interesimit të tyre përmes dramën shqipe. Ne kemi mjaft regjisoriët që e duan dramën shqipe, si Elma Doresi, Jeton Neziri, Hervin Culi, Refet Abazi, Andia Xhunga, Ili Bokshi, Ben Apolloni, Ferdinand Hysi, Stefan Çapaliku, Blerta Neziri, etj. Jo gjithmonë përkrahen iniciativat e tyre përmes dramën shqipe. Politikat e repertorit gati e përgjashojnë atë. Drama shqipe në Teatrin kombëtar në Tiranë përzgjidhet kohëve të fundit përmes netëve të leximit të dramës shqipe. Është një metodë e mirë leximi i dramës shqipe, por edhe kjo praktikë është lënë mënjanë. Megjithatë, nëse drama përzgjidhet, është i luntur ai autor që beson vërtetë se drama shkruhet në teatër dhe e shkruan aty variantin përfundimtar. Unë kam pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me regjisoren Andia Xhunga në Teatrin kombëtar përmes komedinë TAG, ku vështrimit regjisorial përmes një atmosferë retro i jam përgjigjur me rishkrime të tekstit. Po kështu kam pasur fatin të punoj me regjisori Hervin Culi, që i ka dhënë fryshtësuar të shëndetshme tekstit të shkruar nga unë.

HEJZA: Dëgjojmë shpesh ankesa përmes kritikave të humorit të shëndoshës në komedi dhe përmes mbushjen e tyre me banalitetë. Cilat janë recetat e një komediografi të njoftuar si Ju?

B. HOXHA: Receta nuk më pëlqen të jep, por mund të them se edhe shkrimi i komedisë dhe humorit që bëhet në të përfshihen në studimin e standardeve të shkrimit të dramave dhe komedive. Teknika e shkrimit të dramës është një profesion ku zbatohen disa rregulla, ku disa rregulla të tjera pasi i ke njoftur edhe mund t'i anashkalosh. Kohët e fundit në skenë është një gjitje shumë humor estradës, edhe nga padja. Aktorët punojnë përbatutën dhe jo përmes procesin e personazhit. Rikthimi i rënjes së zharrimit është edhe evitimi i kësaj dukurie që e ka banalizuar skenën e teatrit.

HEJZA: Në teatrot tona vijet re prirja përmes vënës në skenë sa më shume veprat që autorëve të huaj. Mendoni se kjo gjë i dekoracionit autorët e mirëfilltë të dramës dhe komedisë sonë?

B. HOXHA: Sigurisht i dekoracion. Përmes tepërisë, përgjedhja e parë përmes ndërtuar një projekt është në dorën e regjisoreve që e kanë përpjekur të zharrin një komedie e mirëfilltë.

përkëtë mjerim!

B. HOXHA: Po, është e vërtetë që drama nuk përfillet. Po të kishte ndodhur kjo shekuj më parë, ne nuk do të kishim Faustin, nuk do të kishim asnjë prej veprave të Shekspirit dhe të tërë repertorit e teatrit antik apo Çehovin e Durremahtin. Botuesit e lidhin botimin me lexuesin bashkëkohorë, por në rastin e dramës duhet të jepin kontribut të në kulturën kombëtare, të vendosin në biblioteka dramën e shkruar, edhe në emrë të së ardhmes.

HEJZA: Kritika teatrale? Në botë çdo teatër ka të angazhuar profesionalisht kritikët e vet! Te ne kush po i zbërrthen problemet teatrale, shfaqjet, mbarështimet regjisoriale, që nga koncepti, mizanskena e deri te loja e aktorëve!

B. HOXHA: Te ne nuk ka kritikë teatrale. ZAKONISHT kemi shkrime informuese që i referohen vlerësimet e bëjnë regjisori përmes përvratës së shkrimit e tyre profesionalës dhe të kulturës së përgjithshme si dhe zhvillimet bashkëkohore, pa lënë pas dore traditën artistike dhe pasurinë që ka krijuar njoftim.

HEJZA: Si e shikoni fatin e dramës si tekst letar! Drama shqiptare, si botim, si libër i botuar, nuk merret parasysh nga teatrot tona "kombëtar", nuk përfillet nuk botuesit tanë! Letërsia bashkëkohore gjithnjë e më shumë po na del më e varfër përsëri sa i përket këtij illoji letar, kurse askush nuk brengoset

HEJZA: Çfarë po ndodhë me publikun? Dikur një shfaqje përsëri është dhjetëra e dhjetëra herë! Kemi më pak publik teatër-dashës apo do t'i lëmë fajin mediave elektronike që teatrin, por dëshironë, po n'a sjellin në dhomë! Cili është sot perceptimi i të rinjve përmes teatrin! Cili është angazhimi i shkollave tona përmes dramaturgjinë shqiptare?

B. HOXHA: Publiku dhe të rinjtë e duan teatrin e mirë. Në sallën e teatrit unë kam parë shumë njerëz, midis tyre edhe të rinj. Në shkolla kam asistuar në vënie në skenë nga maturantët të disa prej dramave bashkëkohore. Këto shfaqje amatore janë ndjekur me entuziazëm nga bashkëmoshatarët e tyre dhe e kanë përjetuar si një festë shfaqjen. Puna është se askush nuk e ka në konsideratë këtë pasion të tyre. I bishet shkurt dëshironë se rinia e sotme e konsideron një gjë të vjetruar e të kapërcyer teatrin. Nuk është kështu. Po të ndaleshim në një analizë, mund të gjendeshim mjaft pikë të rëndësishme të teatrit me brezin e kompjuterëve dëshironë se inteligjencës artificiale.

HEJZA: Çfarë drame origjinalë i duhet teatrove tona, publikut, lexuesit! Si të tejkalojët profili sozialist i teatrove tona, si mos ta dëmtojmë motivin e realizmit magjik, si mos ta bastardojmë teatrin absurd..?

B. HOXHA: Kur një gjini është në krizë, shoqëria ndalet dëshironë se arsyeton motivet themelore që e lindin dëshironë jetë këtë gjini. Teatri quhet ndryshe edhe art i gjallë. Përveç këtu duhet kërkuar edhe kapërcimi i kritizave: si të bashkojmë fryshtësuarin e personazheve me fryshtësuarin e spektatorit, me histori domethënës, duke evitar moralizimet, teatrin ideologjik dëshironë se parimet e ngurta të socializmit apo mungesën e komunikimit ku të çon keqkuptimi i teatrit absurd. Duhet menduar si ta çojmë sërisht teatrin në rëndësën me të cilin lindi, si të bëjmë atë që përmendët ju në fillim që dramat dëshironë finale të kenë katarsisin. Por, jemi shumë larg dëshironë se përfat të keq nuk janë të gjithë bashkë në këtë shqetësim të gjithë njerzit e teatrit.

HEJZA: Mbas romanit tuaj të suksesit "Duartrokës" dëshironë se ende pa u shuar jehona e botimit të tij, ju botuat romanin tjetër, "Asnjëherë të martën". Cila është arsyja e kësaj ngutje?

B. HOXHA: Pas pak muajsh jam shtatëdhjetë vjeç dëshironë se përfat moshën time kjo ngutje besoj se është e mirëkuptuar.

HEJZA: Cilat janë lidhjet shpirtërore të një autorit si ju me personazhet e romaneve tuaja?

B. HOXHA: Më dhimbën dëshironë se përpigjet t'i justifikoj në çdo rrëthanë.



Një "imperativ kategorik"

TË USHTROJMË DEMOKRCINË PËRBALLË OLIGARKIVE

Në veprën "Paqja e përjetshme" Kanti formulon atë që, sot nga të gjithë filozofët e politikës, njihet si "forma transcendentale e autoritetit" (pra, e së drejtës publike): "Të gjitha aksionet që kanë të bëjnë me të drejtën e njerëzve, maksima e të cilave nuk pajtohet me transparencën, janë të padrejta"

Gersa RRUDHA

"Demokracia është një kalë i madh dhe i fortë race, por pikërisht për madhësinë e tij, edhe pak i ngathët, ndaj dhe aq shumë nevojar për t'u ngucur vazhdimisht nga një zekth". Kështu mendonte Sokrati e kështu sillej ai edhe në jetën praktike, duke i nxitur të gjithë të tjerët të shtronin vazhdimisht pyetje mbi gjithçka që i rrëthonë, pa mëtuar të arrinin gjithmonë në përgjigje të pakundërshtueshme. E rëndësishme është të jesh i "bezdiッシュëm" si një zekth, për të shrmangur "magjepsjen" nga dukja, shpesh aq e rehatshme për ata që kanë frikë ta përvshkojnë "detin e jetës" si një liri. Sokrati-zekth kthehet kështu në emblemën e stimuluesit më të madh të demokracisë që nuk rreshë së dyshuar, binduri e qortuari deri në bezdi. Ky zekth duhet të kthehet në një qasje sisteme, në një të ardhme të domosdoshme kritike ndaj saj. "Të qenët në krizë, theksori Zagrebelsky, është gjendja e natyrshme e demokracisë". Ndaj, nëse sot e trajtojmë një gjë të tillë sikur të ishte një risi, është vetëm për shkak se jemi të pajisur me një kujtesë "kohë-shkurtër". Përkufizimi më i arrirë (e njëherësh utopist) i saj është padyshim ai i demokracisë si "vetë-qeverisje" e plotë e qytetarëve që Rusoi, në fillim të "kontratës shoqërore" pat shpallur si program të kërkimeve të tij: "Gjendjen e një forme shoqërizim... nëpërmjet të cilës çdo njeri, i bashkuar me të gjithë, t'i bindet vetëm vvetetë e të qëndrojë po kaq i lirë sa q'ishte dhe më parë". Një ideal demokratik i shpalosur dhe i realizuar plotësisht sipas formules se Rusit është i parelidhueshëm, por ajo çka përbën thelin e saj është pikërisht aspirimi për t'u afuar ose për t'mos i larguar jo më pak se sa gjendemi realistik, këtij ideali. Pra, demokracia nuk duhet të shihet si një regjim i konsoliduar, i përcaktuar, i sigurt në vvetetë. Përkundrazi, kritikat kundër mendimit demokratik, si "mistifikues" i realitetit, e kanë bazën në të ashtuquajturën "ligji i hekurit i oligarkisë". Kjo shprehje e saj nga Robert Michels, për t'u referuar sociologjisë së partive politike socialiste, vlen në përgjithësi për të treguar prirjen e pandalueshme të çdo organizimi shoqëror, për formimin e "grupeve të kufizuar" që arrinjë të marrin udhëheqjen, pra të elitave. Në vvetetë elitat nuk janë aspak në kontrast me demokracinë. Janë të pajtueshme dhe të nevojshme për të organizuar, kanalizuar dhe mobilizuar energjinë e shpërndarë të turmës, d.m.th. për t'i shtënë ato në veprim. Në këtë kuptim, demokracia është një luftë e përjetshme për pohimin e saj kundra oligarkive që arrinjë t'i lindin gjithmonë nga përbrenda. Ja, një luftë të tillë, duket se e ka humbur sot demokracia shqiptare, përdoriso ka mundur të jepë "fryte të pjkur", në jetën tonë shoqërore një mpleksje e rezikshme e oligarkisë me demagogjinë në pushtet.

Për të konkretizuar fenomenin do të shqyrtojmë në fillim modelin klasik të demokracisë atheniane, ku gjenden shembuj mjaft kuptimplotë të c'mitizimit të këtij aspekti. Më i spikaturi është ai i Aristofanit, tekso përmend kontrastin e ashpër midis dy demagogëve të asaj kohe për kontrollin e popullit. Pasi edhe në epokën e saj më të artë (në shekullin V), demokracia arriti të "nxjerrë" nga gjiri i saj një oligarki të caktuar, të personifikuar madje tek vëtë Perikliu, tek "princi i demokracisë", siç



quhej atëherë. E shpjegon më mirë Aristoteli, kur përvshkuar përplasjen për pushtet midis Simonit dhe Perikliut dhe mjeteve të përdorura prej tyre për të fituar mbi njëri-tjetrin. Simoni, që zotëronte një pasuri përrallore, mbante shumë njerëz të "demos-it" me ushqime e para. Kushdo mund të shkonte në shtëpinë e tij e të merrete çfarë të dëshironë. Nuk kishte limit në përdorimin e pasurisë për askënd. Perikliu, që nuk mund ta përballonë dot një gjë të tillë, thjesht mendoi të shpërdoronte funksionet publike të shtetit, duke i dhënë kështu origjinë "shthurjes së institucioneve", dhe "shprishjes së dokeve dhe zakoneve" të vendit. Favorizimi për njerëzit u arrit, qoftë nëpërmjet pasurinë private (si Simoni), qoftë nëpërmjet asaj publike (si Perikliu). Në të dyja rastet, vota u korruptua po njëlljo.

Nëse do ta reflektonim këtë shembull me demokracinë shqiptare, mund të themi se ajo e ka shfaqur herë pas here një qëndrim të tillë të kokë-përrmbysur në raport me sjelljen ndaj qytetarëve. Në veprën "Paqja e përjetshme" Kanti formulon atë që, sot nga të gjithë filozofët e politikës, njihet si "forma transcendentale e autoritetit" (pra, e së drejtës publike): "Të gjitha aksionet që kanë të bëjnë me të drejtën e njerëzve, maksima e të cilave nuk pajtohet me transparencën, janë të padrejta". Në këtë kuptim, "kriteri kantian i qeverisjes së mire", siç njihet përgjithësisht kriteri i mësipërm, konsiston në konsiderimin e demokracisë si një "qeveri të fuqisë publike në publik", pasi veprimet që kërkohet t'u fshihet qëllimi d.m.th. motivi që i vë në lëvizje, i përvidhen kontrollit të arsyes dhe opinionit publik. Pushteti, kësisoj, është shumë më i dukshëm, sa më afër qytetarëve që të jetë.

Analiza e derikëtushme e gjendjes të së sotmes shqiptare i dëfton qartë rrënijet e të këqijave dhe prapambetjes së saj, tek

tilla si solidariteti, shkëmbimi i përvjosh, bashkë me angazhimin për të tejkaluar egoizmin njerëzor dhe distancat midis klasave.

Në shoqërinë e sotme individi shqiptar jeton mes kontraditave të forta, që nga njëra anë ia shkaktojnë prirjet individualiste të favorizuara nga çdo aspekt i jetës, dhe nga ana tjeter, nevoja e qenësishme për t'i mbajtur të shtrënguara lidhjet e tij sociale. Mirëpo, në një shoqëri të shëndetshme demokratike, kjo kontradiktë është i papërballueshëm, pasi demokracia ka nevojë si për zhvillimin dhe shpalosjen e kapacitetit të individit ashtu dhe për solidaritetin dhe gjithë-përfshirjen. Po si do të mund të lidheshin në lëvizjen edukative, këto dy parimet të socialitetit dhe zhvillimit individual? Zgjidhja nuk është e lehtë, por mënyra më e mirë për t'u përballur me krisën e demokracisë është ajo e pohimtët që një ideal demokratik, që nuk mësoshet nga theksimi i një raporti asimetrik midis nxënësit dhe mësuesit apo më mësuesi i një raporti në themel autoritar, siç ndodh në pedagogjinë e sotme. Në masën në të cilën kjo asimetri nuk do të vihet në krizë nga ana e sjelljes së mësuesve, në po atë masë shkolla nuk do të favorizojë, por do të pengojë edukimin e një demokracie autentike. Qytetar që ka mësuar në shkollë t'i uniformohet një autoriteti ose të ndjekë mësimet e një "mësuesi autoritar", vështirë se në jetë do të arrijë të luftojë logjikën e inferioritetit dhe të synojë njohjen publike të dinjitetit dhe gjendjes së vet të barabartë me të gjithë të tjerët. Në këtë kuptim, edukimi demokratik nis si një marrëdhënie midis mësuesit dhe nxënësit, për t'u rimenduar më në thëllësi si një marrëdhënie simetrike e gjithë shoqërisë. Ai e kapérçen konceptin e "autoritetit" me atë të "kooperimit" me nxënësin në kërkim të së vërtetës dhe rritjes së përbashkët. Pedagogu nuk është një model, pika fiksë e procesit evolues të studentit, por një person i angazhuar së bashku me studentët e tij përgjatë një procesi njohje të bashkë-ndarë. Në këtë proces, roli i tij është ai i udhëheqësit të një "ekspedite kah një toke të njohur vetëm pjesërisht". Pasi çdokush, sado të forta të janë bazat e kulturës dhe fuqisë së tij shpirtërore, nuk duhet ta konsiderojë veten asnjë tjetër përvce një eksplorator i thjeshtë i realitetit kompleks që përfaqëson njeriu, mundsitet dhe pritshmëritë e tij. Për këtë arsy, struktura më e përshtatshme ndaj idealit të edukimit demokratik është ajo e grupit të kërkimit; një grup njerëzish që ndërtojnë një njohje duke u vlerësuar dhe duke u irritur reciprokisht, duke komunikuar në mënyrë të thellë me njëri-tjetrin, duke i shpalosur në mënyrë kreative kompetencat e tyre, nën udhëheqjen e një pedagogu apo mësuesi që nuk e transmeton drejtëpërdrejt njohjen, por koordinon dhe orienton punën e përbashkët. Nëse edukimi institucional i shkollës së sotme ka një program të përcaktuar dhe një sistem dijesht për t'u transmetuar, edukimi demokratik nuk mund të jetë ndryshe përvce i hapur, si në përbajtje ashtu dhe në metodologji. Nëse në edukimin institucional programi përcaktohet nga lart në nivel qendor (nëpërmjet kurikulave), duke bërë që vëtë aktiviteti didaktik të programohet nga mësuesi, në procesin e edukimit demokratik përcaktimi i temave dhe argumenteve të studimit bëhet në mënyrë

gjithë-pjesëmarrëse, duke konsideruar edhe lirinë e kuptimit apo nxënies, përtjerë asaj të mësimdhënies. Më tej, edukimi demokratik karakterizohet nga hapja e tij ndaj përvojave jetësore, ndërkokë që edukimi institucional individualizon vetëm një fushë të përvojës njerëzore, atë që i korrespondon vlerave, kulturës, stilit të jetës të klasave udhëheqëse. Është, pra, në thelb, një edukim klasor, në të cilin nuk gjeljet vend puna manuale, kapacitetet praktike apo kultura materiale. Kultura, në edukimin institucional, paraqitet pak a shumë në mënyrë të përgjithshme, si një instrument i vlefshëm për njojhen dhe pohimin në jetë të individit. Ndërsa edukimi demokratik ka një koncept kulture të ngjashëm me një kërkim të hapur, të përbashkët, të lirë dhe çlirues për individin; Ai nuk kërkon të diktojë një vizion të caktuar mbi njeriun, një thelb të përcaktuar njerëzor domosdoshmërisht ideologjik, por përkundrazi, respektton ekzistencën e çdokujt bashkë me lirinë e tij pëtë kërkuar dhe ndërtuar vetvenet lirisht, përmes eksplorimit të sa më shumë dimensioneve.

Nisur nga këto parime, thelbë i një edukimi autentik demokratik do të perifrazohej si një pedagogji politike, nisur nga një shprehje e Pol Rikér-it të përdorur në një studim të tij mbi Munier-in, pëtë përcaktuar "një pedagogji të një jete komunitare të lidhur me një rizgjerim tërësor të njeriut, të personalitetit të tij". Në këtë kuptim, çështja që shtron kjo lloj pedagogjje është gjetja e atij tipi edukimi që është deri në fund koheren me idealin demokratik të vendit dhe kohës ku jetojmë. Ndaj, nëse do të pyesnim se cila është mënyra më e mirë pëtë edukuar, metod-

ologjikisht, përgjigja duhet të merrete parasysh lidhjen e pandashme midis mjeteve dhe qëllimeve. Nëse qëllimi i edukimit është një shoqëri njerëzish të lirë dhe të barabartë, mjeti nuk mund të jetë veçse një edukim që respekteton në mënyrë rigorozë lirinë dhe barazinë; ndërsa, nëse qëllimi është një shoqëri në të cilën të gjithë të zotërojnë pushtet, edukimi më i mirë nuk mund të jetë veçse ai që i mëson njerëzit gradualisht dhe konkretisht me ushtrimin e pushtetit. Ja, pse, shkalla e zhvillimit dhe shpërhapjes së një edukimi të tillë është një pasqyrë që tregon shkallën e vërtetë të gjendjes së demokracisë së një vendi. Për këtë arsy, lëvizja për edukimin demokratik, si e vëtmja rrugë koherente për shëndoshjen e këtij sistemi në shoqërinë shqiptare, duhet të ketë si busull parimin e Xhon Djuit, sipas të cilit "raporti midis demokracisë dhe edukimit është një raport i ndërsjellët dhe vital". "Demokracia, në vetvete, është një parim edukativ", theksón ai, "një masë dhe një direktivë", për këtë arsy, hapi i parë që duhet hedhur është kuptimi i thellë dhe zbatimi kapilar i konceptit të demokracisë si proces edukativ pa të cilin individi nuk mund të arrrijë në zotërimin e plotë të vvetves, as të kontributit, nëpërmjet kapaciteteve të tij, në mirëqenien sociale të të tjerëve dhe ambientit të cilit i përket. Institucionet edukative, për rrjedhim, kanë për detyrë të organizohen si "laboratorë të demokracisë", duke filluar që nga shkolla, pëtë konkretizuar kështu një tjetër parim themelor të trashëgimisë djuijane, atë të lidhjes së ngushtë që ekziston midis demokracisë shkolllore dhe demokracisë sociale. Nuk mund të kemi një demokraci autentike sociale, nëse ajo nuk ushtronet


para së gjithash në brendësi të "institutione shkollore, në një klimë pjesëmarrjeje të lirë mes mësuesve, nxënësve dhe forcave sociale". Demokracia, sado që është e ekspozuar vazhdimisht kah rreziqeve të degjenerimit dhe zvenitjes, sado që kthehet shpesh objekt i transformimit dhe i modeleve të rind interpretativë, duhet të ruajë medoemos vlerën e saj të qenësishme irregulluese, duke promovuar një model të demokracisë pjesëmarrëse dhe duke i shtrirë sa më shumë hapësirat e mundësive konkrete për çdo person, në mënyrë që ai të arrijë të ushtrojë të drejtën e vet të qytetarësë. Ky duhet të jetë aspekti i dytë themelor nga ku duhet të prijet lëvizja për një edukim autentik demokratik. Aq më tepër që një qytetarësi e tillë, në rrjedhën e proceseve të pandalshme të globalizimit, kërkon përjashtimisht një bashkë-rendim të parimeve etiko-politike, akoma dhe më parë se sa ato ekonomiko-financiare. Po në çmënyrë mund t'i bashkojmë e t'i integrojmë të tilla parime? Edhe një herë na vjen në ndihmë ai model têrësor formimi, ajo bashkësi procesh edukativë që e kulturojnë dhe e sociolozjnë individin, duke synuar gjithmonë ta bëjë të aftë të qëndrojë në mënyrë dialektike buzë këtyre kufijve pluralë, kulturalë dhe socialë. Për arritjen e këtij qëllimi bëhet themelor roli i atij që në kontekste të ndryshme e me funksione të veçanta, merret me detyrën e edukimit. Spikatja etike e rolit të tij profesional duket të jetë i lidhur drejtësia me finalitetin, përbajtjen dhe modalitetin me të cilën çdo "profesionist i edukimit" u drejtobet njerëzve që synon të edukojë, duke pasur gjithmonë kujdes për delikatesën e rolit që

kryen dhe për pasojat që ai edukim mund të lërë jo vetëm mbi personin por edhe mbi komunitetin të cilin ai i përket. Në këtë kuptim, interpretimi i formimit të individit si përkujdesje ndaj personit, ndaj kontekstit organizativ dhe komunitetit social, përbrendëson në vetvete edhe përpjekjet e "kultivimit të performancës" së këtyre "professionistëve të edukimit". Kjo e fundit nuk identifikohet vetëm në sasinë dhe cilësinë e dijeve dhe aftësive, por përfshin edhe motivimin, vlerat, imazhin dhe tërë misionin që i ka caktuar shoqëria. Ndërsa, përsa i përket individit, ai duhet të sforcohet të kultivojë në çdo kohë "kundrimin e vet të brendshëm", d.m.th. atë lloj kundrimi ku syri i tij që nga përbrenda të arrijë të shohë jetët e të gjithë të tjerëve.

Ashtu siç e ka pëershruar edhe vetë shkrirtari afro-amerikan Ralf Ellison, ai që e pat sajtar këtë shprehje në romanin e mrekullueshëm "Njeriu i padukshëm", çdo vepë arti, ashtu si dhe një roman, mund të shndërrohet në një "argsh perceptimi, zbavitje dhe shprese, mbi të cilën demokracia mund të kalojë "vorbulat dhe pengesat" që qëndrojnë midis individëve dhe "idealit demokratik". Ky është një tjetër hap i rëndësishëm që duhet hedhur nëse duam që lëvizja për edukimin demokratik të ketë sukses: duhet t'i japim mbështetje një edukimi të pasur me vlerat e arteve dhe të studimeve humanistike, pasi një edukim që mbivlerëson lëndët shkencore ndaj atyre filozofike e shoqërore, pra, që i jep edukimit një orientim përjashtimisht të ndikuar nga ekonomia dhe utiliteti i saj, rrezikon të dëmtojë rëndë mendimin kritik, kundrimin e brendshëm etik e kësijoj, edhe vetë jetën e demokracisë.

Një "imperativ kategorik"

SABATO, NJERIU



(Fragmente nga libri biografik)

Në shkurt të 1980, gazeta "La Vanguardia" e Barcelonës i paraqiti Sabatos Pyetësorin Proust, bazuar në pyetjet e autorit të "Në kërkim të kohës së humbur", përtu përgjigjur me shkrin në një album. Pyetjes se ku dësh-

ronte të jetonte, ky bir emigrantësh kalabrezë iu përgjigj:

«Aty ku jetoj, në tokën time. Ashtu siç është, e pafat, me të meta, është imja. Sepse, aty kam lindur, aty kam qenë fémijë, aty kam pasur iluzione, aty kam pasur èndrra për të ndryshuar botën, aty kam dashur, aty kam

vuajtur. Sepse, ajo tokë na mëkoi jo vetëm gëzimet dhe vitytet e saj, por, mbi të gjitha, edhe me brengat e pasiguritë e saj.»

Ajo lidhje u këp写了 për Françeskën dhe Xhiovanan para se të agonte shekulli i XX. Dhe mbrapa mbetën èndrrat që patën, dëshirat për të ndryshuar botën dhe lidhjet e fortë familjare. Mbase, me duart e tyre punëtore nuk e kishin prekur dot kurrë lumturinë e vërtetë, mbase, atje, në Kalabri, lumturia përtë që vetëm e ashpër, e vrasdhë dhe tepër e shkurtë, por pikërisht atje mësuan ç'ishte drita, aroma, shija, tingujt dhe tërë misteret e fëmijërisë.

Françesko Sabatoja kishte lindur në brigjet e detit Tirren, ndërsa e shoja, Xhiovana Ferraro, në San Martino di Finita, një fshat në Apenine, në rajonin Paola, ku katërqind vjet më parë që strehuar si refugiat një komunitet shqiptar, i cili kishte ruajtur me xhelozin gjuhën dhe zakonet e veta.

Edhe sot e kësaj dite, banorët e atyre krahanë janë aq shqiptarë sa çjanë edhe italiane. Ernesto Toçi, stërgjyshja e të cilët ishte kushërra e parë e gjyshes nga nëna e Ernesto Sabatos, është një nga mbrëjtësit më të mirë të rrënësve kulturore të komunitetit shqiptar. Përtë treguar forcën shpirtërore të atij populli vital, ai tregon historinë e një profesori shqiptar të lindur në Kalabri, fémijët e të cilët flisnin shumë mirë shqip, italisht, anglisht dhe frëngjisht. Aty nga fundi i viteve gjashëdhjetë (shekullit XX) profesori jetonte në Paris, ku jepte kurse të gjuhës dhe letërsisë italiane. Një mbrëmje, kur u kthye nga universiteti, dëgjoi që bijtë e tij bisedonin frëngjisht me njëri-tjetrin. Atëherë, mblodhi familjen dhe duke treguar derën e shtëpisë tha:

- Kjo derë mbylljet jo vetëm pëtë mos hyrë qentë dhe furtunat, por edhe pëtë mos dalë prej këtej ajo çka na përket vetëm neve. Nën këtë çati do të flitet vetëm gjuha jonë shqipe. Kurrë mos harroni se jemi shqiptarë.

Profesor Toçi ka hulumtuar historitë e disa banorëve të San Martino di Finita-s, midis tyre edhe të Ferrarëve, paraardhësve të nënës së Ernesto Sábatos, dhe sot përpigjet të rimëkëmbë artezaninë që po zhduket.

«Kam organizuar kurse pëtë përhapur teknikën e hershme të tjerrjes – tregon Toçi pa e fshehur krenarinë e vet. – Disa shtresa të pajës së nuses stërgjyshërit tanë i bënë duke tjerrë fije gjineshtre, bimë e egër që rritet në krahinën tonë. Tani, kjo aftësi ka humbur. Po ashtu është zhdukur krimbi i mëndafshit filli i mëndafshit që prodhohej këtu eksportohej në qytetet e lulëzuara të Lukës, Venecias dhe Firences».

Ka mundësi që edhe Xhiovana Ferraro të ketë endur ndonjë çull me fije gjineshtre në pajën e saj. Kjo grua fine, e fliste në mënyrë të përsosur shqipen, të vetmen gjuhë që kishte mësuar në fshat qysh në fëmijëri. Por në Argjentinë, ku duhet të quhej jo Xhiovana po Huana (Juana), me kohë nuk e foli dot më. I ati i Sábatos, përkundrazi, ishte një fshatar i kalabrez, i varfër nga ekonomia dhe edukimi, që nuk dinte gjë për paraardhësit dhe origjinën e tij cifute.

Në një intervistë të botuar në një revistë në Kalabri, para tridhjetë vjetësh, Sabatoja thotë:

«Jam tepër krenar për çfarë unë kam prej shqiptari. Gjithmonë më është dukur e habitshme që një bir italiano, si unë, të ketë të tillë vetëdjë për vdekjen.»

Tek «Engjelli i skëterrës» (Abaddón, el exterminador), romani i tretë i tij, Sabatoja tregon se, kur ai vetë ndodhet në Paris, kërkonte një gramatikë të gjuhës shqipe. Shpesh pëtë përligjor temperamentin e vet, Sabatoja përmend fjalët e Gijom Apoliner (Guillaume Apollinaire) për popullin shqiptar: «Energi i mbinjerëzore dhe prirje për vetëvrasje. Duket gjë e papajtueshme? Sipas meje, kjo është karakteristikë race». (Në shqip: B. Karaboli)

BOTËVËSHTRIMI-DOMOSDOSHMËRI PRAKTIKE APO SFIDË TEORIKE

Nëse diçka e karakterizon epokën tonë, ajo është humbja e besimit në transcendencë, në Zotin si Realitet Objektiv. Është epoka e ekklisit të transcendencës. Asnjë mjedis socio-kulturor në epokën paramoderne nuk ia ktheu shpinën transcendencës në një mënyrë kaq sistematike siç bëri modernizmi

Nga Metin IZETI

Koha e re është e përqendruar në humbjen e besimit, pra, besimi, në kuptimin e dyfishtë të fesë, të Zotit dhe besueshmërisë, sigurisë transcedente. Pavarësisht pretendimit të saj përtu dhënë liri dhe dinjitet njerëzve ajo e ka lënë të zhveshur njeriun në udhëkryq. Ka krijuar shumë dilema, në aspekt të kërkimit të zgjidhjes mund të konsiderohen të arsyeshme, që e kanë lënë njeriun e sotshëm në mjetin transportues duke mos e bartur deri tek caku. Si rrjedhojë, mos arritja e cakut dhe përpëlita në rrugë dhe lajthitje e devijime rrujore e mendore, e ka shtuar depresionin dhe paqartësinë e vendzënies së njeriut në hapësirë. Hapësira e gjërë jetësore, e cilësuar kështu nga Zbulesa, është ngushtuar aq shumë sa që njeriun e ka lodhur edhe vetë prania e tij në Tokë. Shumë me elokuencë e ka përkufizuar këtë gjendje Muhammed Ikbali në një katër-vargësh të tij:

Çfarë është kjo epokë, në të cilën feja/besueshmëria vajton?

Liria e tij vjen me një mijë pranga,

Ajo i rrëmbeu fytyrës së njeriut shkëlqimin dhe njomësinë,

Dhe Bihzadi (një piktor i njohur iranian i shekullit XVI) i pikturoi një pamje të rreme.

Për sa i përket mendësisë apo botëvështrimit, aktualisht po jetojmë në "Epokën e Ankthit, e emërtuar kështu nga shumë kritikë të modernizmit në lindje dhe perëndim. Nëse e analizojmë pulsin e kohës dhe shikojmë përtetë simptomave përtë gjetur shkakun parës, atëherë e kuptojmë se diçka nuk është në rregull me paradigmat ose botëvështrimet mbizotëruese që përfaqësohen në kohën tonë. Njeriu i sotshëm, me kritikat e tij filozofike, dilemat ekzistenciale dhe specifikat shkencore, e gjen veten në një gjendje të çuditshme: koncepti i krijuar post-humanist i tij i jep atij kontroll të paparë mbi forcat e natyrës, por i grabit besimin në të ardhmen e tij.

Humbja e besimit në transcendencë

Kriza në të cilën bota gjendet në fillim të shekullit të 21-të është më e thellë se vetë organizimi i sistemeve dhe ekonomive politike. Në mënyra të ndryshme, Lindja dhe Perëndimi po kalojnë një krizë të përbashkët të shkaktuar nga gjendja shpirtërore e modernizmit të mbapshtë. Kjo gjendje karakterizohet nga një humbje e sigurisë fetare dhe transcendencës me horizonte më të mëdha. Natyra e asaj humbjeje është e çuditshme, por në fund të fundit është mjaft logjike. Kur, me inaugurimin e një këndvështrimi shkencor të botës, njerëzit fillojnë ta konsiderojnë veten masën e gjithçkaje, bartës të kuptimeve më të larta në botë, kuptimi do të fillojë të zbehet dhe njerëzishmëria do të pakësohet. Bota po humbet dimensionin e saj njerëzor dhe ne kemi filluar të humbasim kontrollin mbi të. Sipas F. Schuon: "Bota është e mjerë, sepse njerëzit jetojnë nën nnderin e tyre; gabimi i



njeriut modern është dëshira përtë reformuar botën pa forcën dhe vullnetin përtë ndryshuar njeriun; me kontradiktat e saj të padurueshme, përpjekja përtë bërë një botë më të mirë të buazuar në përkeqësimin e njerëzimit, mund të përfundojë vetëm në shfuqizimin e asaj që është njerëzore, dhe rrjedhimisht në shfuqizimin e lumturisë. Të ndryshosh njeriun do të thotë ta rilidhesh atë me Xhenetin, të rivendosësh një lidhje të re me transcendencën, që tashmë është prishur. Ky proces përfaqëson çrrënjosjen e tij nga sundimi i pasionit, nga kulti i materies, sasi e dhe dinakërisë dhe riintegrin e tij në botën e shpirtit dhe qetësisë, madje mund të themi: në botën e arsyeve të mjaftueshme (suficite).

Nëse diçka e karakterizon epokën tonë, ajo është humbja e besimit në transcendencë, në Zotin si Realitet Objektiv. Është epoka e ekklisit të transcendencës. Asnjë mjedis socio-kulturor në epokën paramoderne nuk ia ktheu shpinën transcendencës në një mënyrë kaq sistematike siç bëri modernizmi. Ekclipsi i transcendencës ndikon në mënyrën tonë të shikimit të botës, d.m.th. në formimin e një pamjeje të gjerë të botës. Transcendencë, do të thotë, se ekziston një realitet tjetër që është më real, më i fortë dhe më i mirë se i përbotshmi. Ekclipsi i transcendencës ndikon në mënyrën tonë të shikimit të botës, d.m.th. mbi formimin e një botëvështri. Kjo pyetje dhe ky problem është shumë shqetësues. Gjithçka që ka të bëjë me fushat shoqëruese të jetës: politika, standardi i jetës, kushtet ekologjike, marrëdhëniet ndërpersionale, arti, në analizë të fundit varet nga këndvështrimi

ynë përtë botën. Njeriu i shekullit të XX-të duke braktisur të menduarit e qartë, i lejoi vetes të fiksohet aq shumë me anën materiale të jetës, saqë shkencës i la një konto të hapur, një kontroll të plotë përtë pretendimet shkencore rrëth asaj që përbën realitet, njoħuri dhe besim të justifikuar. Ky është shkaku i kriżes sonë shpirtërore. Ajo iu bashkua kriżave të tjerar kur hymé nē shekullin e ri - kriżat mjedisore, popullsia e madhe, hendeku nē iritte midis të pasurve dhe të varfërve, depresioni, stresi, droga, amoraliteti, kotësia e të ngashme.

Është fakt që shkenca e ka ndryshuar botën tonë sa që nuk mund ta njohim atë, por fakti që shkenca ka ndryshuar botëvështrimin tonë është mjaftë intriguese. Më e rëndësishmja, dy botëvështrime konkurrejnë përtë prestigji në të ardhmen, botëvështrimi me prani të tij përtëjmes në jetën tonë dhe botëvështrimi i përqendruar në ndryshimin e realitetit përmes shkencës trans-humanë. Por një gjë është shumë e qartë përtë njeriun e mileniumit të tretë, një vështrim puro-shkencor i botës është një shkreti përtë shpirtin njerëzor dhe nuk mund të na sigurojë një jetë kuptimplotë.

Instrumenti i soditjes është zemra

Botëvështrimi është një këndvështrim gjithëpërfshirës dhe duhet të bëhet dallimi midis përbërësve të tij social, kozmologjik dhe metafizik. Komponenti social i botëkuptimit nga e kalura ndonjëherë justifikon skllavérinë dhe të drejtat hyjnore të mbretërve, ndërsa komponentët kozmologjikë e përshkruajnë universin fizik siç kuptohet nga shkenca e sotme. Përbajtja e këtyre dy komponentëve

dukshëm ndryshon, ato nuk janë të përjetshme. Filozofia e përjetshme, e pandryshueshme është metafizike ose, më saktë, ontologjike. Kjo i referohet ndryshimit midis absolutes dhe relatives dhe shkallëve të ndryshme të realitetit që rrjedhin nga to.

Kriteri i trefishtë, metafizika, kozmologjia dhe sociologjia, ka zgjatjet e tij në traditën pereniale, modernizëm dhe postmodernizëm. Kur i kahasojmë këto probleme me tre periudha kryesore të historisë njerëzore: periudhën tradicionale, modernizmin dhe postmodernizmin, është e qartë se e para prej këtyre periudhave shpenzoi më shumë nga energjia e saj dhe ishte më e mirë, në disa aspekte se dy periudhat e tjera. Domethënë, modernizmi na dha një kuptim të natyrës, ndërsa postmodernizmi i zgjidh padrjësitet sociale më me vendosmëri se sa periudha më parë. Kjo krijon botëkuptime metafizike të ndryshme nga ato kozmologjike, të cilat kufizohen në universin empirik. Ndërsa, dobësia kryesore shfaqet në mosndjekjen e arritjeve të tij parëve. Është pra, fenomeni i ekklisit të transcendencës. Kjo është ajo që është e gabuar me paradigmën ose botëvështrimin e periudhës tonë. Ky është ndryshimi konceptual që u solli njerëzve projektit iluminist dhe botëkuptimi i modernizmit, si dhe dëmi që u bë në qarqet shkencore akademike.

Shikuar nga kjo perspektivë, kthimi i trascendencës, përmes përshtipshëmërisë, është një sistem që mund të shërbejë në kontekst të riparimit. Kjo është një ontologji e përshtipshme që merret me natyrën e realitetit, një epistemologji që flet për origjinën, mënyrën dhe fuqinë e dijes dhe çështjen e fortësisë dhe pasaktësisë së dijes, etikën, filozofinë e së mirës dhe të keqes dhe psikologjinë.

Lind një pyetje e rëndësishme: A kanë njerëzit aftesi, të barabarta apo të ngjashme me receptorët e tyre shqisore, përtë zbuluar gjérat jomatiale, shpirtërore? Kanti mendonte se ata nuk ekzistojnë, dhe epistemologjia, në pjesën më të madhe, ishte dakord me këtë mendim, por feja nuk ishte dakord. Nuk ka asnjë mënyrë objektive përtë zgjidhur mosmarrëveshjen, sepse secila palë ka përkufizimin e vet të objektivitetit. Në fund, del se njerëzit pajtohen me shkencën, sensin e shëndoshë dhe postmodernizmin, dijen objektive, atë që është e dukshme, sepse ajo e lavdëron vetveten. Epistemologjia fetare, nga ana tjetër, e përcaktion njohurinë objektive si të përshtatshme. Kur Realiteti përtë cilin po flasim është i karakterit shpirtëror, atëherë duhet një forcë e vegantë si dhe instrumente të veçanta. Kjo është e nevojshe përtë zhvilluar dhe përtë ta mbajtur në fokus.

Instrumenti i soditjes është zemra, por jo arsyaja me të cilën jemi njohur në jetën tonë të zakonshme. Në të menduarit modern, njeriu e percepton botën objektive përmes shqisave të tij dhe i kupton ose i "shpjegon" ato me ndihmën e një aftësie mendore të quaj-

tur arsyo ose intelekt; nuk ka mënyrë tjetër pér të marrë njohuri. Sado që ky kuptim éshëtë krejtësisht në kundërshtim me doktrinat tradicionale të epistemologjisë të lashtë éshëtë në kundërshtim edhe me kuptimet e sfidave që na i paraqet e ardhmja.

Të gjitha fetë në epokën moderne janë deriuar të shpjegojnë doktrinën e tyre duke patur parasysh mbështetjen e kritikës së Kantit. Duke marrë me vete një rrezik të ekzagjerimit të vogël, mund të thuhet se çdo teolog, teoricien kontemplativ, filozof dhe mendimtar në epokën postkantiane, para se të vazhdonte me idenë e tij kreative, duhej të "zgjidhë" llogarinë me Kantin. Edhe René Guénon, figura drejtuese e shkollës tradicionale, që rrallë ndoqi stilin "shkencor/orientalist" të referencave dhe shënimave në veprat e tij dë që ruante gjithmonë një nivel më të lartë të ligjërimit, në idetë e tij bëri një përfashtim pér Kantin. Një tjetër figurë e shquar e mendimtar tradicional, F. Schuon, i dha përgjigje edhe Kantit në fillimet e hershme të karrierës së tij si shkrimitar, në artikullin "Reflektimi mbi sentimentalizmin ideologjik". Vëzhgimet e tij bazohen në një vështirësim të gjithmonë që gjëra e nga këndvështrime të ndryshme dhe duke mos i përfashtuar traditat e lashta, jo vetëm ata të feve të shpallura por edhe të religjioneve dhe botëkuptimeve të lindjes së largët.

Nëse marrim shembullin e një doktrine krejtësisht intelektuale dhe të eliminuar nga emocionet, siç éshëtë filozofia e Kantit, e cila u konsiderua si arketipi i teorive të ndara në dukje nga poezia, nuk do të kemi asnjë vështirësi pér të zbuluar se pikënisja ose "dogma" éshëtë reduktuar në reagimin e paarsyeshëm ndaj gjithçkaje që qëndron përtëj mundësive të vetë arsyes, prandaj apriori ai shpreh instinktivisht revoltën ndaj të vërtetave që janë racionalisht të pakuptueshme dhe që konsiderohen të pakëndshme pér shkak të pamundësise së tyre pér shpjegim të thjeshtë. Gjithçka tjetër éshëtë thjesht një fazë dialektike, nëse doni, zgjuarsi "brilante", por në kundërshtim me të vërtetën. Ajo që éshëtë thelbësore në filozofinë e Kantit nuk éshëtë logjika e tij pro domo dhe qartësitet e saj shumë të kufizuara, por kryesishet déshira "irracionale" pér të kufizuar inteligjencën pér të cilën ai flet; kjo rezulton në dehumanizimin e inteligjencës dhe hap derën pér të gjitha devijimet çnjerëzore të shekullit tonë. Shkurt, nëse éshëtë e mundur që një gjendje e caktuar e njeriut të tejkalojë intelektualisht vetveten, atëherë filozofia e Kantit éshëtë mohimi i gjithçkaje që éshëtë në thelb dhe integralisht njerëzore.

Dërgjegjja Hyjnore

Në kohët e lashta njerëzit flisnin në mënyrë fëminore pér gjérat inteligjente, në ditët tona njerëzit konkurrojnë pér të folur me inteligjencë pér gjëra marrëzie, konstaton Ikbali dhe vazhdon, në atë kohë, kur bënini gabime, i bënini pér çështjet e mundshme, jo pér gjérat themelore; në epokën tonë éshëtë e réndësishme që njerëzit janë në gabim, ndërkohë që kanë një mendim pozitiv pér gjérat e mundshme... Tendenca karakteristike e kohës sonë - pér faktin se "zotat" janë eliminuar - éshëtë se çdo gjë éshëtë e kristalizuar ne filozofi. Çdo gjë bëhet objekt besimi, çdo lloj reagimi sentimental apo dobësimi i inteligjencës apo vullnetit. Éshëtë sikur këmbët e dikujt, të lodhur nga natyra, fillojnë të mendojnë sipas asaj që i pëlqen dhe i përshtatet vetes - vetëm sepse kanë menduar pér zënien e pozitës qendrore në aspekt të idësë. Një sekunçi e ngjashme mendimesh, por jo në tonin e ekstravagancave moderne, qoftë pér filozofinë, letërsinë, artin apo, thjesht, pér një mënyrë jetese të caktuar, quhet "braktisje e kohës". Por ajo që njerëzit harrojnë éshëtë se koha janë ka braktisur të vërtetën dhe të gjitha vlerat reale. Na thuhet se asgjë nuk mund dhe nuk duhet të jetë jashtë hapit me kohën, sikur nuk janë në hap me Zotin, dhe sikur të jetë e mundur të jesh pafundësish jashtë hapit me tre gjëra: Zotin, të vërtetën dhe thelbën e gjëra... Përgjatë shekujuve, fetë kanë rrënjosur te njeriu ndërgjegjen e asaj që ai



éshëtë në madhështinë e tij themelore së bashku me papërsosmërinë dhe pafuqinë e tij aktuale; njeriu e pranoi këtë mesazh sepse ai ende posedonte një intuitë natyrore të vendit të tij në univers. Tani éshëtë një karakteristikë e një njeriu të etur përt'u bashkuar me kohën tonë, nevoja pér të ndjerë lehtësi në papërsosmëri, e cila pér të éshëtë bërë përsosmëri praktike... Nga pikëpamja e realitetit eskatologjik, në të cilin asgjë nuk mund të mbetet e imunizuar nga përllogaritja përfundimtare, të gjitha polemikat racionaliste-sentimentale do të dukeshin si një lloj loje letrale e dënuar me avullim të menjëherëshëm në humnerën që shtrihet deri tek varri.

Gjithsesi duhet patur parasysh, se realiteti përfundimtar zbulon simbolet e tij, në botën e jashtme dhe te njerëzit dhe pér këtë arsy mund të quhet imantështim i pafundit. Vëzhgimi reflektes i natyrës éshëtë një mënyrë indirekte, racionale pér të arritur atë Realitet; intuita éshëtë një mënyrë e drejtëpërdrejtë, jo racionale pér ta arritur këtë. Pozicioni i fundit vlefshimërinë e të cilat e ka vërtetuar dhe zbuluar letërsia mistike botërore, nuk éshëtë më pak e natyrrshe dhe e singertë dhe jo më pak efektive në synimin bujar të dijes konkrete dhe reale. Megjithatë, të dy llojet e njohurive duhet të plotësojnë njëra-tjetër pér të kriuar një vizion të plotë të Realitetit.

Prandaj, një vëtëdije e përshtiptshme éshëtë thelbësore pér botëvështrimin praktik, dhe kjo éshëtë ajo që e lejon njeriun të trajtojë me respekt figura si, Muhammedin a.s., Jezu Krishtin. Mojsiun, Budën, dhe shumë të tjera nga fe të ndryshme që synojnë ta rrrokin realitetin përfundimtar. Ky realitet më së shpeshti

lexohet përmes dashurisë dhe jo vetëm përmes diturisë. Ose, më saktë, tema bazë që éshëtë endur në filozofinë e tyre éshëtë urtësia e dashurisë, éshëtë një lojë mes urtësise dhe dashurisë që gjeneron mirënjohje të thellë ose harmoni shpirtron me vlerat që jetojnë në urtësinë pereniale. Siç ka vënë nëndukje edhe S. H. Nasr, "metafizika më e thellë në Islam mund të gjendet në shkrimet e dijetarëve sufi, veçanërisht atyre që zgjodhën të merren me aspektet teorike të rrugës shpirtërore, ose atë që scientia sacra e quan gnosis (el-Ùirfan)".

Në këndvështrimin e metafizikës sufike, fenomeni i ndërgjegjes, i cili shfaqet në botë në mënyrë hierarkike, éshëtë shfaqja e Ndërgjegjes Hyjnore. Manifestimi qendror dhe i plotë i Ndërgjegjes Hyjnore, vëtëshpallja (texhel-li) e Atributeve Hyjnore të Dipes (Ùilm), éshëtë inteligjencia njerëzore. Në të njëjtën mënyrë, vetëm njeriu, i cili ka dhuntinë e të folurit, i vërteti ndërkrijesat tokësore, u krijua në shëmbëlltyrën e Zotit dhe ky éshëtë kulmi dhe përsosmëria e inteligjencës njerëzore, dhe rrjetimisht e vëtëdijes njerëzore. Ligjërimi, në këtë rast, éshëtë një trup i parëndësishëm, me gjithëse i ndjeshëm i vullnetit dhe të kuptuarit tonë.

Virtyti si vepër e së vërtetës

Éshëtë e rëndësishme të theksohet këtu se thelbë i argumentit pér të përgjegjeshtruar Kantin éshëtë zgjerimi i kufijve të sferës së ndërgjegjes dhe theksimi i faktit se ndërgjegjja nuk duhet reduktuar vetëm në racionalitet, d.m.th. mendimin diskursiv, apo arsyen e ndarë nga rrënja e saj intelektuale transcendentale, që éshëtë zemra, sepse, realiteti i përgjithshëm ka mënyra të shumta pér të pushtuar ndërg-

jegjen tonë, ka "mënyra mbiracionale të vetëdijes", "ka mundësi të niveleve të panjohura të vetëdijes".

Bota formale përbëhet nga dualiteti. Arsyja, pasi përashtohet në bazë të "rënieve" së saj në substancë materiale dhe psikike, ndahet në dy pole: në atë intelektual dhe në tjetrin, ekzistencial; ndahet në inteligjencë dhe ekzistencë, në tru dhe trup. Në Intelekt, inteligjencia éshëtë ekzistencë, dhe anasjelltas; dallimi i aspekteve në vëtvete nuk nënkupton një ndarje. Ndarja ndodh vetëm në botën e formës. Truri éshëtë pér trupin ashtu siç éshëtë zemra pér trurin dhe trupin së bashku. Trupi dhe truri projektohen në forma momentale dhe zemra éshëtë e zhytur në pandryshueshmërinë e Qenies. Si të thuash, trupi dhe truri kanë vërvshuar nga zemra.

Jeta e njeriut zhvillohet në tre plane njëkohësisht, domethënë egoja éshëtë objekt i tre qendrave të têrheqes ndaj të cilave ai përgjigjet në mënyra të ndryshme, në përputhje me natyrën ose vlerat e veta. Ne jetojmë në trup, kokë dhe zemër në të njëjtën kohë, kështu që ndonjëherë mund të pyesim veten se ku éshëtë në të vërtetë, egoja, 'vetja' empirike, ka vendet e saj ndjore në tru, por graviton drejt trupi dhe përpinqet të identifikohet me të, ndërsa zemra éshëtë, simbolikisht, selia e Qenies, pér të cilën mund të jemi të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm, megjithëse éshëtë qendra jonë reale ekzistenciale, intelektuale dhe universale. Në një farë kuptimi, éshëtë treshja e vjetër anima, animus, spiritus, me ndryshimin se anima éshëtë 'gruaja' e animusit- éshëtë një ent psikik mjaft vegjetativ dhe shtazor i ndarë nga vëtë trupi; këtu nuk ka një vijë të qartë demarkacioni, sepse trupi nuk mund të ndahet nga ndjenjat e tij, të cilat në fakt përfaqësojnë egon tonë të ulët dhe të decentralizuar, me ngarkesën e tij në rënje dhe tendencat disperse, do të thotë Schuon.

Do ta përfundoj me disa konstatime të Schuonit (Isa Nuruddin), njeriu në të gjitha periudhat, por veçanërisht tash, ka nevojë ekzistenciale pér të rrrokur të Vërtetën e vërtetë. E vërteta éshëtë ajo që duhet pranuar absolutisht. Dhe kur bëhet fjalë pér të Vërtetën absolute, ajo duhet pranuar plotësisht, d.m.th. me gjithçka, me inteligjencë, me vullnet, me dashuri, këmbëngulje, iniciativë, fat. Ky pranim total i së Vërtetës éshëtë Besueshmëri, siguri, mirëqenë. Të thuash se pranimi éshëtë i plotë do të thotë se ai ndodh në zemrën tonë, nga e cila varen fuqitë tona të tjera. Dhe të thuash se pranimi na mbush zemrën éshëtë, në fakt, të thuash se ai përshtatet me gjithçka që jemi, aktiviteton dhe karakterin tonë. Kjo éshëtë arsyja pse éshëtë e pamundur të kesh Besim pa rrjedhoja ose pa poseduari cilësi që përshtaten me Besimin, nga ku rrjedh se e vërteta éshëtë ajo që e përcaktion atë. Ndërtë gjithë mundësitë, ajo që varet më së shumti nga e Vërteta dhe në të cilën Besimi pasqyrohet më shpejt nga ai fakt éshëtë Lutja dhe thelbë i Lutjes éshëtë emri i Zotit. Pér të pranuar të Vërtetën duhet të kesh Besim; zotërimi i Besimit éshëtë kthimi te Zoti, sepse njeriu éshëtë i pajisur me inteligjencë, i aftë pér absolutisht ose transcendencë dhe kjo éshëtë ajo që manifestohet në Dërgesën Hyjnore. Por zemra nuk éshëtë e dukshme vetëm në veprimet tona, ajo éshëtë e dukshme edhe në karakterin tonë; dhe nëse e Vërteta dhe Besimi i detyrojnë veprimet tona në punë shpirtërore dhe të zellshme, ato e detyrojnë njëloj karakterin tonë drejt Virtytit shpirtëror dhe të bekuar. Sepse Puna nuk éshëtë asgjë pa Virtytin, ose pa qëllimin e Virtytit, ashtu si e Vërteta, pa Besimin, mbetet një shkronjë e vdekur në letër. Anasjelltas, Besimi nuk éshëtë asgjë pa të Vërtetën dhe Virtuti nuk éshëtë asgjë pa Punën. Një arsy e mjaftueshme pér Besimin éshëtë padishim e Vërteta, dhe plotësimi i pandashëm i Virtytit éshëtë Vepra e së Vërtetës. Besimi pa të Vërtetën éshëtë herezi; Dituria pa besim éshëtë hipokrizi. Puna pa virtyt éshëtë mendjemadhi i vepriti pa punë éshëtë kotësi; sepse sinqueriti i Virtytit therrët në Punë dhe përsosmëria e Punës therrët në Virtyt.

DESHIFRIMI I SHENJAVE TË JETËS

Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje dhe aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandje, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan

Le CLEZIO

Nuk mund të arratisesh ngajeta. Unë nuk jam i qetë, jo, nuk jam i qetë. Unë jetoja, jam në jetë, lëviz, hedh fuzhnjat dhe shigjetat e mia, gjuaj, përgjoj nga lukthi i territ. Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje e aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandje, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan. Unë shkruaj me të dyja këmbët e mia kur eci, me dhëmbët e mi kur ha. Unë shkruaj me të gjithë trupin tim, me shtatin e grave, me dhembjen, kënaqësinë, me fryshten time. Dhe shkruhem gjatë gjithë kohës nga bota, pa mundur të them jo. Ajri ka kaluar mbi këtë truall dhe shiu ka rrjedhur shpesh nëpër këto lugje. Ç'gjë të shkruar ka atje? Çfarë është shënuar në këtë rrasë? Emrat e të vdekurve, afërmendsh, dhe gjurmët spirale të gishtërinjve të gjallëve. Edhe nënshkrimet. Datat e ditëve e shifrat e orëve, numrat e viteve, fazat e hënës, erërat, baticat, shpërthimet diellore. Numri i gjethive të drurëve. Luspat e gjarpërinjve, gjymtyrët e shumëkëmbësheve. Hala peshqish, mbetje të moçme, mbeturina gostie, thërrime, sa shumë thërrime! Pikërisht kjo është prona ime, burgu im. Nuk do të dal prej këtej; por dua të numëroj kokrrizat e rërës e t'i vë se cilës një emër, meqë kjo është e vetmja arsy e jetës sime. Asgjë nuk më shkatërron dot më përnjëmend. Gjithçka që ndodh, ndodh shumë larg, si në një botë tjetër. Unë jam i ulur, ndoshta përballë përfjetësisë. Aksidente, pasione, dëshira, drojë, të gjitha këto janë brenda meje, lëvizin, gjallërohen, vazhdojnë të luftojnë. Brenda vetes vështroj; mbruj. Shfaqje aq e zakonshme, saqë bëhet joshpërfillëse, por krijon. Si t'i shpëtosh romanit? Si t'i shpëtosh gjuhës? Si t'i shpëtosh, qoftë edhe një herë të vetme, qoftë edhe fjalës thikë? Nuk mund të arratisesh ngajeta. Sa herë që dikush dëshiron të shkruajë, ja se çfarë duhet të bëjë: duhet të blejë një pako me letër të bardhë 21x 27 dhe një stilolaps të zi. Del nga shtëpia ndonjë ditë, aty rreth orës tre e dhjetë të pasdrekës dhe çapitet nëpër rrugë midis turmës së zhurmshme. Zbret dy shkallë, u bie mes përmes disa kopshtive, ecën me kilometra përgjatë trotuaresh të përhime, ku bie pluhuri. Kapërcen më këmbë lumenjtë e makinate, duke shmangur gomat me vizatime gjallëronjëse. U hedh një vështirim semaforëve me dritë të kuqe a të gjelbër, që shkëlqejnë majë shtyllash çeliku, si dhe dritave portokalli që pulsojnë nëpër kryqëzime.

Ai ecën me këmbët e veta nëpër gjurmë të padukshme, bën përparrë me trupin paksa të hepar, me duart që i tunden në përfund krahëve. Vështron ftyrat dhe këmbët e grave, qëndron, niset sérish, çik paksa veshje, rrëshqet përgjatë pasqyrash, shumë i zbehtë, ose më mirë kridhet në pasqyrimet e metalit të zi, yll i errët që tretet në pafundësi. Ecën përmbi hijen e vet të lehtë. Përparrë një dyqani me farfuri të rëndomta e ëmbëlake, ai ndez një cigare me dy-tri fije shkrepësesh prej druri. Dielli i ka qëndruar në qafë, e djeg qëtësish dhe i nxjerr ca bulëza vocë-

rake djerse. Herë-herë, nga moria njerëzore në lëvizje, ia beh një fytyrë e brengosur, me sy përpirës, me flegrat dihatëse të hundës. Mandje ajo largohet, ngritur majë supeve porsi emblemë. Ajri është i tejdushëm, ajri është i rëndë, të hyn në mushkëri porsi një rrënje me brirthë të lëngët. Zhurmërimat vërshojnë, shpërthime të pakuptueshme që çajnë udhët e tyre me kraterë. Rrugët zhyten thellë nëpër murana pallatesh të bardheme; në të vërtetë, ato nuk të çojnë kurkund. Sheshet janë të pamata, më të gjera se aeroportet, më të shkreta se rrafshinat akullnajore. Aty sipër duhet ecur, kalamendur, rendur. Pikërisht këta emra duhen gjermëzuar, këto fytyra duhen njohur, këto fjallë duhen thënë. Nuk ka vend për trill, nuk ka mundësi për të vërtetë, as për gjëneshtë. Është vetëm ky vis, gjatë gjithë kohës, nga njëri horizont në tjetrin.

rrjedhur shpesh nëpër këto lugje. Ç'gjë të shkruar ka atje? Çfarë është shënuar në këtë rrasë? Emrat e të vdekurve, afërmendsh, dhe gjurmët spirale të gishtërinjve të gjallëve. Edhe nënshkrimet. Datat e ditëve e shifrat e orëve, numrat e viteve, fazat e hënës, erërat, baticat, shpërthimet diellore. Numri i gjethive të drurëve. Luspat e gjarpërinjve, gjymtyrët e shumëkëmbësheve. Hala peshqish, mbetje të moçme, mbeturina gostie, thërrime, sa shumë thërrime!

Pikërisht kjo është prona ime, burgu im. Nuk do të dal prej këtej; por dua të numëroj kokrrizat e rërës e t'i vë se cilës një emër, meqë kjo është e vetmja arsy e jetës sime. Asgjë nuk më shkatërron dot më përnjëmend. Gjithçka që ndodh, ndodh shumë larg, si në një botë tjetër. Unë jam i ulur, ndoshta përballë përfjetësisë. Aksidente, pasione, dëshira, drojë, të gjitha këto janë brenda meje, lëvizin, gjallërohen, vazhdojnë të luftojnë. Brenda vetes vështroj; mbruj. Shfaqje aq e zakonshme, saqë bëhet joshpërfillëse, por krijon. Si t'i shpëtosh romanit? Si t'i shpëtosh gjuhës? Si t'i shpëtosh, qoftë edhe një herë të vetme, qoftë edhe fjalës thikë?



meje, lëvizin, gjallërohen, vazhdojnë të luftojnë. Brenda vetes vështroj; mbruj. Shfaqje aq e zakonshme, saqë bëhet joshpërfillëse, por krijon. Si t'i shpëtosh romanit? Si t'i shpëtosh gjuhës? Si t'i shpëtosh, qoftë edhe një herë të vetme, qoftë edhe fjalës thikë?

Në gjithë shtrirjen e rrafshët të botës është vendosur dialogu. Është një çorbë gjuhe dhe çdo fjalë është në vendin e vet, ndërsa ai zëzëllin porsi mizë e palëvizur përmbi llokmén e mishit. Mijëra gojët voçerrake të sendeve e të njerëzve kumbojnë së bashku. Unë jam secila nga këto ngjarje, unë mbart brenda vetes vilen e vezëve të fjalëve që do të mposhtin. Ajo çka them, ajo çka mendoj, ajo çka jam është e shënuar në ushtrinë e shenjave që përaparojnë. Jam fluturim mizash, lakahredha e mushkonjave të acaruar. Jam barbarozë e burgosur te vazaja e kuqe, që nuk do të pëlcasë kurrë. Jam lëvizja budallaqë, dridhja e mbytur, duarlëvizje e dëshirës, çast i etjes, i urisë, i plenimit, i jashtëqitjes, i gjumit, i fjalës. Jam shpalimi, mandje tkurrja. Muskuli dhe, në krye të krahut me vena të shëndosura, është grushti që shtrëngon thikë e mpreshët. Jam ngrrohtësia e diellit, 100.000 vite dritë nga njëri breg

në tjetrin i Udhës së Qumëshit. Shpina e grusës rioshe hepohet, ndërsa dora e saj mban penelin e hollë që shkruan në ngjyrë trëndafili te thonjtë e gishtave të këmbës. Vetëtima çan qellin që nxihet befas, ndërsa sinjal i saj lëbrys do të thotë diçka të tmerrshme, që nuk mund të përkthehet. Aty janë, shkruar kuturu nëpër mure, copat e letrave të shqyera, shpina e zarfave, mbulesat e tavolinave, paketat e cigareve, numratorët e telefonave, gazetat, librat, biletat e avionit, etiketa birre.


Nuk arratisem ngajeta që di të shkruaj. Muret janë ngritur, dyert e dritaret janë mbyllur. Tavani, dyshemja, qilimat, mbulesat janë gatitur. Letrat janë ngjitur, xhamat përtypur, tablotë të varura. Gjithçka është aty, gati dhe asgjë nuk mungon. Qelia. Dhoma hermetike, e kotë, hapësirë e mbramë torturash, vend që nuk braktiset kurrë. Nga kupa e tavanit varet llambë e zhveshur elektrike me rreze vdekjeprurëse. Shtrati është rregulluar. Çdo gjë në vendin e vet, çdo hi në taketuken e vet. Enë, vazo të përjetshme, kuti që hapen mekanikisht, për të parë, dhe ekziston gjithmonë një kuti e re, ende, sérish. Gazeta që hapim, vazhdimisht në faqe të reja. Ka qaq shumë për të lexuar, qaq shumë fjalë të reja, histori të botës së paprerë. Askush nuk rri në paqe. Gjithçka që jeton është duke shkruar, me dorën, zërin, kthetrat, dhëmbët, me thumbat e tij plot helm të fshehur. Universi është një fletë e bardhë gjigante që të gjithë bëjnë çmos më kot për ta ndotur. Nuk ka asgjë, asnjë situatë a veprim, që të mos ketë shenjën e vet, shkronjën, klapën katrore a pikën e zezë. Gishtërinj, janë gishtërinj mbërthyes, që kërkijnë të mbyllen përmbi prenë e panjohur. Bota arratiset dhe rifillon porsi uji, por çdo pikë e këtij uji është një kurth i ngrehur.

Unë nuk jam i qetë, jo, nuk jam i qetë. Dhe unë ia shtoj liqenet e mia ngatërimit të përgjithshëm, jo për të çiruar, jo për të kuptuar, por për të përpirë, edhe unë, me të gjitha thimthat e mia me thitha të hapura. Unë jetoja, jam në jetë, lëviz, hedh fuzhnjat dhe shigjetat e mia, gjuaj, përgjoj nga lukthi i territ. Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje dhe aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandje, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan. Unë shkruaj me të dyja këmbët e mia kur eci, me dhëmbët e mi kur ha. Unë shkruaj me të gjithë trupin tim, me shtatin e grave, me dhembjen, kënaqësinë, me fryshten time. Dhe shkruhem gjatë gjithë kohës nga bota, pa mundur të them jo. Gjithsesi, sa herë që dikush do të shkruaj, ja se c'duhet të bëjë: lipset të çapitet përmes rrugëve të qytetit, midis turmës lëvizëse, deri te shitorja e madhe plot najlon e dritë. Me të holla duhet të blejë një pako 100 fletësh letre të bardhë shtypi 21x 27. Po i mbeti ndonjë qindarkë, duhet të shkojë pak më tej dhe, i përkulur mbi banak, të zgjedhë një stilolaps të zi, me mbishkrimin REYNOLDS, a diçka e këtillë. Atëherë gjithçka është gati, i mbetet vetëm të rikopojë...

Ai që i dha shumë letërsisë botërore

GABO

Tema e vëtmisë përshkon si një fill i kuq të gjithë veprën e Markezit. "Dashuri në kohë të kolerës", ashtu si shumica e veprave, eksploroni ekskluzivisht vëtminë e personit dhe të krejt njerëzimit, gjë që shprehet nëpërmjet vëtmisë së dashurisë dhe të tē dashuruarit.



Grigor JOVANI

Çështë ky njeri, plak rondokop, që shëtit i vëtmuar në një bregdet të Karaibeve në Kolumbi, me një "sombbrero vueltiao" mbi kokë, si vendas klasik? I thërrasin "Gabo", një emër i zakonshëm për autohtonët e atij vendi. E pra, çështë Gabriel García Markezi, njéri nga shkrimtarët më të njohur të botës. Ngjan një copë e pandarë e atij bregu, i gjithë atij reliivi, i atyre njerëzve që mbartin histori shekuish mbi supe. Nuk çështë aspak e çuditshme që më të shumtët e historive të Markezit, të cilat mahnitën gjithë rruzzullimin njerëzor, kanë lindur dhe janë pjesë organike e asaj bote të vogël atje, e atyre njerëzve lëkurënxirë, si ai. Por, çështë më tej ky shkrimtar?

STILI

"Tek çdo libër mundohem tē përshkoj një rrugë të veçantë... Nuk më bie në mendje për të ashtuquajturin "stil". Asnjë shkrimtar nuk e përzgjedh atë opiori. Mund tē zhbironi, duke u përpjekur të gjeni stilin më të mirë për qđo temë. Mirëpo, tema e përcaktori stilin, sipas preferencës së çdo kohe. Nëse do të mundoheni të përdorni një stil tē pa përshtatshëm, thjesht nuk do të funksionojë. Në vazhdim, kritikët shpikin teori rrëth kësaj çështjeje dhe shkojnë gjëra që vetë shkrimtarët nuk i ka parë. I referohem vëtëm mënyrës sonë tē jetesës, tē jetës në Karaibe..."

Lamë tē fliste vëtë shkrimtarët. Ç'mund tē themi më tepër?! Vetë ai ka zakon tē mos i thotë tē gjitha. I pëlqen tē lerë nënkuptim. Xhanëm, kjo ra në sy qysh në fillim tek ai: gjoja "harron" tē shtojë tek shkrimtarët e veta hollësira tē rëndësishme ngjarës po kaq me rëndësi, me qëllim që lexuesi tē detyrohet tē angazhohet edhe ai në punën e shkrimtarët, tē vazhdojë më tej historinë që "la mangut" krijuesi i saj. (Këtu ngjan pak me Brehtin). Shembulli më i mirë për këtë "harresë tē gjithershme" çështë romani "Kolonelit nuk ka kush t'i shkru-

ajë" (No One Writes to the Colonel), ku nuk pagëzohen me emra konkretë karakteret kryesore. Kjo praktikë, e huazuar nga veprat e shkrimtarëve antikë grekë, si tek "Antigona" dhe "Edipi mbret", ku shumë elementë tē rëndësishëm lihen jashtë skenës, i përshtat shumë Markezit. Ato i dorëzohen fantazisë së lexuesit, le ta vazhdojë dhe ta perfeksionojë historinë ai, sipas realitetit që jeton. Nuk fund tē fundit, nuk do t'i bëjë tē gjitha shkrimtarët, le tē gjejë lexuesi emrat tek "Koloneli"... Le tē përdorë për tē përvojën që ka nga e përditshmja dhe njerëzit që e rrethojnë.

Realizmi magjik

Natyrisht, çështë një rrymë, një shkollë shkrimi, që mahnitët dhe kaploët botën letrare. Përfaqësuesi kryesor, Gabriel García Markezi. Realiteti çështë një nga temat më të genësishme dhe tē rëndësishme në tē gjitha veprat e Markezit. Vetë ai thotë për veprat e tij tē para (me përashtim romanin "Stuhia e gjethive"), siç janë "Kolonelit nuk ka kush t'i shkruajë", "Në orën e keqe", "Funerali i Nënëmadhes", se tē gjitha pasqyrojnë realitetin e jetës në Kolumbi dhe kjo temë përcaktori edhe logjikën. Nuk pendohem që i shkruajta, por i takojnë një lloj letërsisë tē paramenduar, e cila ofron një tē përditshmë tejet statike, që nuk vazhdon tē zhvillohet analogjikisht me realitetin..."

E ndryshoi këtë. Tek veprat e mëvonshme eksperimentoi një realitet më pak tradicional. Pse? E sqaron vetë: "Me qëllim që gjérat më tē frikshme, ato jo dhe kaq tē zakonshme, tē thuhën me "shprehen e vdekur". Këtu pikërisht fillon i ashtuquajturi "realizmi magjik" i tij. Kjo çështë lidhja kyç midis traditës dhe realitetit, risia që mahnitët, nuk fund tē fundit, planetin e letrave. Shembull konkret çështë një pasazh tek "Njëqind vjet vëtmi", ku një personazh ngritët fiziqisht dhe shpirtërisht në qill, teksa

nder rrobat e tij për t'u tharë. Shkrimtarët kubanës, Alejo Carpentier, e quan këtë stil shkrimi "mbretëri e mrekullueshme". Pikërisht kjo "mbretëri letra" është "realizmi magjik" i Markezit.

Kritiku i letërsisë, Michael Bell, propozon një kuptim tē ndryshëm tē stilit të Markezit, ngaqë termi "realizmi magjik" është paragjykuar si shumë ekzotik, tē cilin qytetërimi i sotëm, sipas logjikës së tij tē brendshme, e ka nënverësuar dhe lënë mënjanë. Ky paragjykim nuk mund tē përfshijë edhe një shkrimtar si Garcia Markezi, që ndonëse çmon dhe përdor traditën si stil shkrimi, e ka modernizuar aq shumë, sa i përshtatet mrekullueshëm realitetit bashkëkohor. Por, a çështë e ndjeshme kjo për tē gjithë lexuesit, nuk pjesë tē ndryshme tē planetit, mbrijtjumi kultura dhe botëkuptime tē ndryshme? Në lidhje me sa pyetëm më lart, gjatë një bisëdë me mikun e tij Markez, gazetari dhe shkrimtar kolumbian Plinio Apuleyo Mendoza, jep këtë mendim: "Mënyra se si përballesh me realitetin tek librat e tu u quajt "realizëm magjik". Kam përshtypjen se lexuesit e tu evropianë zakonisht e njohin magjinë e historive që shkruan, por nuk mund tē shikojnë tē plotë realitetin që fshihet pas saj. Nuk arrinjë ta perceptojnë tē tèrin. Kjo ndodh sepse metoda ortodologjike e mendimit që kanë, i pengon tē kuptojnë që realiteti nuk mund tē ngushtohet tek... çmimi i domates dhe vezëve..." "Realizëm magjik" vërtet, por kjo vlen kur ke parasysh realitetin që përfjetoi veçanërisht Markezi, atë tē botën e tij, e cila përbën thelbën e librave që shkroi.

VETMIA

Tema e vëtmisë përshkon si një fill i kuq tē gjithë veprën e Markezit. "Dashuri në kohë të kolerës", ashtu si shumica e veprave, eksploroni ekskluzivisht vëtminë e personit dhe tē krejt njerëzimit, gjë që shprehet nëpërmjet vëtmisë së dashurisë dhe tē tē dashuruarit. Gazetari dhe kritiku kolumbian, Plinio Apuleyo Mendoza, pyet shkrimtarin: "Nëse vëtmia çështë temë e tē gjithë librave tē tu, ku duhet tē kërkojmë rrënjet e kësaj ndjeshmëri tē hipobilizuar? Mos vallë tek fëmijëria që ke kaluar?"

Përgjigjet Markezi: "Mendoj se ky çështë një problem që mund ta ketë gjithkush. Dhe çdokush ka mënyrën e tij për ta shprehur. Ndjenja përshkon veprën e kaq shumë shkrimtarëve, ndonëse disa prej tyre mund ta shprehin pa e kuptuar." Gjatë fjalës së tij në Stockholm, duke marrë "Nobelini", Markezi e lidh temën e vëtmisë me përvojën e tij në Amerikën Latine: "Shpjegimi i realitetit tonat, i shërbën qëllimt për tē na bërë gjithnjë e më tē panjohur, më tē huaj, gjithnjë e më pak tē lirë, gjithmonë tē vëtmuar."

DHUNA

Çështë e pranishme nuk shumë vepra të Markezit, duke përfshirë "Kolonelit nuk ka kush t'i shkruajë", "Në orën e keqe" dhe "Stuhia e gjethive". Kemi tē bëjmë me një dhunë shtetërore, politike dhe shoqërore, tē cilën vëtë Markezi e përkufizon kështu: "Ishte një luftë e dhunshme midis konservatorëve dhe liberalëve, e cila zgjati gjëra në dhjetëvjeçarin 1960 dhe shkaktoi vdekjen e qindra mijëra njerëzve në Kolumbi."

Në këtë libra, karakteret jetojnë brenda kushtesh jashtëzakonisht tē vështira, siç janë ndalim-qarkullimet, censura e shtypit, bastisjet dhe krimet politike, në përgjithësi ajo që latinisht në këtë vepra quhet "la violencia". Romani "Në orën e keqe", edhe pse nuk çështë një nga librat e famshme tē shkrimtarit,

shquhet megjithatë për përshkrimin e "la violencias" në tē gjitha format e saj, si edhe për atë që kritika e ka karakterizuar "pasqyra e plasaritur e shpërbërjes shoqërore, që u shkaktua nga dhuna." Mirëpo, ka rëndësi tē nënvizohet fakti: edhe pse Markezi përshkroi natyrën e korrupsionit shoqëror nuk rëndësi tē dhunës, nuk rëndësi tē kurthi përdorimit tē veprés së tij për propagandë politike. Bëri, mbi tē gjitha, art. E rëndësishme për tē ishte (ndonëse shkrimtar kundërshtar i regjimeve tē dhunës) tē shkruante mirë. Romani ideal për tē ishte ai që ndjeshmëronte lexuesin, nëpërmjet forcës së shkrimtarit për tē depërtuar brenda realitetit dhe për tē pasqyruar edhe anët e fshehura tē tij.

MAKONDO

Një tjetër temë e rëndësishme dhe e kudondodhur tek librat e Markezit është ambienti i fshatit, që ai e pagëzon "Makondo". E ka tē gatshme: përdor vendlindjen e tij, Arakatakën e Kolumbisë, si një pikënisje gjeografike, historike dhe kulturore, për tē krijuar atë vendbanim tē imagjinuar letrar. Por përshkrimi i ambientit tē fshatit nuk ngushtohet brenda caqeve tē këtij ambienti. Markezi shpjegon: "Makondo nuk çështë vetëm një vend, por edhe një gjendje e caktuar e truit, e cila ju lejon tē shikoni atë çka doni dhe si dëshironi tē jetë." Edhe atëherë kur rrëfimet e tij nuk i referohen Makondos, prapë vazhdon tē ekzistojë mungesa e papërcaktueshmërisë ekzakte tē vendndodhjes. Kështu, ndërsa rrëfen për "një bregdet tē Karaibeve dhe një provincë në brendësi tē Andeve", edhe këto tē pa përcaktuara saktë gjeografikisht, çështë e dukshme tendencia e shkrimtarit tē përdorë më mirë mitet tradicionale tē provincës, se sa tē arrije tē bëjë një analizë tē caktuar politike. Kjo qytetë e fantazuar, Makondo, çështë bërë shumë e njohur në botën letrare, sikur ekziston në tē vërtetë edhe sot, diku atje, në Karaibe. Sikurse thekson Ilan Stavans, akademik dhe shkrimtar amerikan: "Gjeografia e Makondos janë banorët e saj, mësuesit, politikanët, agjentët turistikë... Kjo e bën tē vështirë tē besosh se ky vendbanim çështë një qytetë artificiale, ndërtuar në mendjen e shkrimtarit."

Për këtë tē fundit, padyshim meritë ka talenti i jashtëzakonshëm i romanierit, që krijon detaje tē qenësishme, për tē ndërtuar një botë reale. Tek "Stuhia e gjethive" sjell tē gjallë fenomenin e epokës së "shpërthimit tē bananeve" në Makondo, një periudhë progresi ekonomik, në sajë edhe tē prezencës tē shoqërive amerikane, por edhe tē têrheqes së tyre, që shkaktuan një rënje ekonomike në provincë. Gjithçka ngjan reale dhe natyrshme. Gjithashtu, tek "Njëqind vjet vëtmi", përshkruhet hollësishët historia e krijuimit tē Makondos, gjë në shkatërimin e saj. Markezi i referohet Makondos edhe tek autobiografia e tij. Përshkruan një udhëtim që bëri me tē emën në vendlindjen e tyre, Arakata, kur ishte i ri. Treni ndaloj tek një stacion që nuk kishte qytet, pastaj u duk një fermë bananesh, e cila shkruante emrin e saj tek një tabelë: Makondo. Kjo ishte. Iu ngulit në tru. Kishte diçka poetike ai emërtim. Nuk mësoi kurrë se ç'nënkuptonte. Vonë, kur ishte rritur shumë tashmë dhe e kishte përdorur këtë emërtim gati në tē gjithë veprën që kishte shkruar, lexoi në një antologji se ishte një bimë tropikale, që i ngjante Ceiba-së. Por kjo pak rëndësi kishte. Makondo kishte mbutur përgjithmonë në histori.

KULTI I FORMËS SI ESENCE E THELBËSORES


(Lexim i "Mbyllur për pushime" romancë historike nga Stefan Çapaliku)

Durim ÇAÇA

Të kundrosh jo letërsinë, por letraritetin dhe literaritetin, jo realen, por tërësinë e virtuale letarre, pra, ndryshe nga kritika dhe poetika e mbyllur klasike e gjinive, zhanreve, etj. të paraprirë që nga Aristoteli e shekuj më pas, drejt një kritike të sotme moderniteti, éshthë krejt e natyrshme në kohën tonë. Për më tepër, një eksplorim të të ndryshmeve mundësi të diskursit, siç éshthë dhe vepra letarre në fjalë që po promovojmë, në Klubin e Librit, Kavajë, me moderatorë, të rinjtë pasionantë të leximit artistik e kulturologjik të këij qyteti, juristi Gert Metani dhe specialisti i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, Thoma Axha, me mbështetje të Ministrisë sonë të Kulturës, përmes Drejtorisë së saj të Librit, si dhe me praninë e autorit dhe botuesit Frano Kulli.

Stefan Çapaliku, éshthë i njohur si prozator me trilogjinë e tij romanore "Secili çmendet sipas mënyrës së vet" e gjer te vepra më e fundit t, "Tregimet e tranzicionit", (2021), si dramaturg i shqar me dramat e tij të absurdit shqiptar të kohës sonë, "Allegro Albania", "Pesë komedi të përgjakshme", etj., si poet me "Kohë e ndalur", etj., si studiues dhe eseist i antropologjisë kulturore me "Arti bashkëkohor shqiptar", "Imago & Verbum", etj., si autor doracakësh "Estetika moderne", "Letërsi e interpretuar", antologjish të vogla (të kohës së izolimit gjatë epidemisë së Kovid-it) për jetën (përbledhje barsetash të komunizmit), apo për vdekjen (preamble filozofike e këndvështrimesh të traditës populllore shqiptare rrëth saj), si regjisor teatri e filmash dokumentarë, përkrythes dhe realizues performancash skenike, etj. dhe, këto ditë, si akademik i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Tek vepra që po vështrojnë, "Mbyllur për pushime" ("Botimet Fishta", Tiranë, 2021), ndryshe nga romani trilogjik, (një vepër e narrativës së "Bildungsroman", sipas termit të filologut gjerman Karl Mongenstern, që klasifikon tilla, vepra letarre që vënë në fokus rritjen psikologjike e morale të protagonistit që nga féminjëria e rinia e hershme e protagonistit deri në moshë të rritur, pra, një roman i edukimit (ku hyjnë romane të famshëm që nga 'David Koperfildi' i Dikens-it, "Torn Xhons-i, i Fielding-ut, "Xhejn Eir" i Sharlotë Bronte-së, "Aventurat e Hekelber Finit" të Tuein-it, "Portreti i artistit në rinin" të Xhojs-it, "Gjuetari i balonave", të Khaled Hysein-it, "Mali magjik" i Man-it, "Gra të vogla" të Alkot-it, "Jeta sekrete e bletëve", të të Sue Mank Kidd, etj., pra, ndryshe nga vepra "Të gjithë çmenden sipas mënyrës së vet", që paraqitet, siç thamë, si një roman i "Bildungsroman", te "Mbyllur për pushime", (një rrëfim i "qëtë" jetësor, në një konstruksion "të lehtë" narracioni), kemi një akuarel letrariteti me tharm historik, që "merret me fatet e njerëzve, të shtrënguar të jetojnë, ndër kontekste krejtësisht të gabuara, - siç paraqitet në portalin e librit, - me dashuritë e palumtura të disa njerëzve, të nisur për të ndërtuar të ardhme të lumtura". Një romancë letarre, në kuptimin e një lirike narrative apo një rrëfim lirik gjendjesh shpirtore rnerëzish, mes shpresash, zhgënjimesh, èndërrimesh, depresionesh e melançolish të një kohe të vështirë. Të treguar si histori personash e personazhesh (historikë e fiktivë) gjatë Historisë së madhe të vendit, ndonëse, në ndonjë rast, arrin dhe kulminacion



dramatik epik, si, bie fjalë, kur Pater Anton Harapi (në roman, Pater Andrea) që, "në betimin e tij si regjent i qeverisë kuinslinge shqiptare para parlamentit, kishte thënë: Me kobure në gjoks, nuk bahet kush as vlla, as shoq, por ja skllav, ja mizor" nuk hypën në avionin e dërguar për të nga Beograd, nga përfqaqësuesi nazist i Ballkanit, për t'u larguar nga Shqipëria, në prag të ardhjes në pushtet të komunitetëve, por "Padria e lexoi për së dyti duke zhytur hundën e tij estradeske, edhe më shumë, në atë letër... Herman Janas s'e kishte kuptuar shqiptarin. Kur ai jepte besën...Dhe e ktheu letrën nga ana tjetër, duke shkruar: Shkëlqesi! Të falem nderës! Unë nuk do ta braktis vendin tim, grigjin time, sidom që të vijë puna. Kam punue veç për fe e atdhe. Të gjithë mund të dëshmojnë këtë! Me përlëshi, Pater Andrea... Pastaj hipë në makinë dhe u nisën rrugës për në Shkodër. Kur kishin lënë mbrapa Tiranën, ...Patër Andrea i tha shoferit të ndalojë. Shoferi hapi krahun dhe priti jasht derisa Patër Andrea hoqi të gjitha rrrobat civile, mbathi sandalet e lëkurës, veshi zhgunin bojë kafe, lidhi mesit litarin trenjësh dhe, duke zbritur nga makina, i tha: Tash unë jam në tokën

time. Ti duhet të kthehesht te famulja yte"; apo në një kulminacion tronditës tragjik (kur usta Mihali që i lutet Profesor Shirokës t'i japë një kostum, kërmishë dhe një pale këpucë, meqenëse kishte të njëjtën gjatësi më djalin e tij dhe profesori i jep kostumin e tij të martesës, (me të dashurën austriake) "atë që ia pati qepur Kolë Tivari, rrobaqepësi më i mirë i pazarit të Shkodrës, me stof anglez, për të cilin i ati, Lazër Shiroka, pati paguar rrumbull gjashtë napolona ari", ustai, që ky i fundit të varrosë të bukur, birin e vet të vetëm të vrarë në masakrën e 4 shkurtit.

Çapaliku rrëfen në veprën në fjalë nga pikëvështrimi i autorit, pra, "raporton" (fakte reale dhe fiktive), në shenjësimin e vet narrativ të literaritetit (të estetikës së shkrimesisë së tij artistike), ku rrëfimi i ofron lexuesit shumë detaje, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, në një distancë të madhe nga ajo që rrëfen (Lufta II Botërore në Shqipëri, vështruar në vitet '20 të shekullit XXI dhe, përmes filtrit dhe aftësisë së njohjes të kësaj pjese përfituese të historisë, (një grupi personazhesh historikë e fiktivë) adopton atë që quhet, sipas Zhenet-it ("Figura, III", 2017:208), vizionin apo pikëvështrimin, duke dhënë

përshtypjen e adoptimit të një perspektive në lidhje me historinë (atë reale-dokumentare dhe artitike-letrare). Një rrëfim ky, në rastin tonë, më shumë se i zhvilluar, éshthë i detajuar dhe ku rrëfimtari (autor) shfaqet vetëm në këtë mënyrë të rrëfyeri, që ka të bëjë në atë që të thuash sa më shumë të jetë e mundur dhe, në të njëjtën kohë, ta thuash këtë "më shumë", sa më pak që të jetë e mundur, mënyrë që bën të harrohet fakti se éshthë rrëfimtari i cili rrëfen. Një teknikë kjo që bashkon predomnimin xhojsian të skenës (rrëfimi i detajuar), me atë të transparencës floberiane të rrëfimtarit.

Janë mësuar, e them me bindje se kanë qasje të gabuar, ta shohin poezinë si udhën e duhur drejt lirizmit dashuror, epshor, erotik apo diç tjetër duke haruar kësijo një mision krejt të një dimensioni tjetër që e mbart në embrionin e saj pikërisht poezia. Sipas Poradecit (Lasgushi më ka thënë), "krijimi i një poezie është metafizikë e tërë e pashpjegueshme" e rrjedhëm qjo rreket të trajtojë në të optikën filozofike të materiis, njjarjes, apo konceptit. Në këtë rrëth vicioz edhe autori zgjedh të argëtojë fjalët e tij, rreshtuar në vargje, duke i mbështjellë ato me nuanca kuptimore filozofike e që sjellin, sipas tij vetë, tokën e huaj të mërgimit, shtegtimin, shpërngruljen por sigurisht edhe dashurinë. Sikurse edhe në fillim, edhe vetë autori duket se i dorëzohet misionit të poetit duke parashtruar se "poetët me gjasë në një luftë të pabarabartë, nga ajo atmosferë shqetësuese mundohen të gjejnë mbetje lirike pér të thurur përsëri të pranishmen dhe të ardhmen".

Dashuria

Duke e bashkëshoqëruar me gjithësinë, të përjetshmen e asaj që e mund pikërisht këtë të fundit, autori na e sjell dashurinë të konturuar në figurën e trëndafilit. E duke mos u rjaftuar me kaq, ai arrin ta shpërndajë pikërisht atë në disa destinacione, së pari duke e ngarkuar me barrën e rëndë të misionarit e së dyti duke u përpjekur ta vendosë atë në botëkuptime të larmishme. Si p.sh. "i pari trëndafil i është kushtuar myezinit / të mjerë, që në agim na pëshpëritë në veshë / nga maja e gjithësisë"; "të dytin trëndafil / e mbafta pér sytë e mi të trishtuar"; "Trëndafili i tretë ishte një urat pér ty" (fq. 83, Pasqyra dhe hija).

Ballkan

Nëse do të duhej të konfigurohej në hartë e gjithë krijimtaria e poetit, padyshim që gjurmë e madhe do të shtrije mbi Ballkan, mbi atë që do dëshiroja të quaja plagë shpirtërore të poezi së tij. Një Ballkan i gjymtuar që sillet, sikurse shprehet vetë Bellizzi "rreth Çmendurisë së kufijve të shteteve" (fq. 77, Pasqyra dhe hija). Në art, padiskutim edhe në poezi, njeriu dhe ngjarja duhet të pasqyrohet reptësishët njeri dhe ngjarje, aspak diçka tjetër. E duke ndjekur këtë parim krejt themelor, kujdeset të përshkruajë Ballkanin si vijon: "Në këtë esplanadë koreografike me shtatore e shatërvanë / u vu në skenë përfaqësimi i historisë dhe konflikteve / me restorantin "Anija e çmendurisë" / që hodhi spirancën përgjatë lumit Vardar / në prite të përhershme si ambulanca e Historisë" (fq. 104, Pasqyra dhe hija). Përpos misionit poetik, duke kompozuar dëshmitë historike e politike, autori ia del të formosojë një tablò të plotë të asaj që Londo do të quante "E zeza tragjike e Ballkanit".

Dhimbja

E konturuar bukur në portretin e Kosovës, poeti përshkruan tej vargjesh atë histori që ndoshta një mori brezash do ta kenë disi të turbullt. Në krijimin me titull "Dita e Ballkanit", pikërisht në poezinë që ia kushton Podrimjes, autori ia del të krijojë shëmbelltyrën e lindjes së Kosovës duke luajtur njëkohësisht si me krijuesin ashtu edhe pushtuesin. "S'që ende i kënaqur / u mendua mire të endë një petk / me një mijë ngjyra / aty këtu, sumbulla ari e argjendi. / ... Po më të bukurat, më të shkëlqyerat / i vuri në gjoksin e Prekazit" (fq. 70, Pasqyra dhe hija). Nga sa më sipër, por edhe duke e lexuar me vërmendje gjithë krijimin, zbatohet saktë parimi i kontemporaniteti dhe universalitetit. Sërisht duke i besuar fjalëve të Poradecit, "poezia duhet të ketë universalitet nëpërmjet konteporanitetit, se kur vdes kontemporanteti ngordh edhe vlera e asaj poezie."

Arbëria

Padiskutim palca e krijimtarisë i takon shtratit shpirtëror të poetit, Arbërisë. Por edhe këtu, ai përpinqet të arrijë diçka më tepër, të shohë përtet asaj që i ofrohet gjithsecilit prej nesh. Poezia nënkuption një palce të tërë përqendrimi e bazuar këtu, në pak fjalë, autori ngre dilemën ndoshta më të qëndrueshme të krijimtarisë e të jetës "Të bukurën More / kërkjmë ende unë dhe Zefi" (fq. 168, Pasqyra dhe hija). Ndoshta priremi të besojmë se ka të drejtë të mallkojë vuajtjen pikërisht ai që shtypet nga ajo. Në gjithë poezinë që i kushtohet pikërisht Moresë, arrin të kuptosh se shpirti është më shumë se jeta e jeta është më shumë se materia.

Në çka mund të lejojë kjo sasi rreshtash, le të shihet si një përpjekje fillestare pér të qëmtuar, pér të arritur deri në gjenezë poezinë e Bellizzit. Një krijimtar i ngarkuar emocionalisht, me karakter lirik pér atdheun, pér të kaluarën, pér heroin e që në mjaff raste të kujton Holderlingun. Ndër të tjera, poezia mbetet hyjnore. Duke qenë veçse realiste, poezia s'mund të bëjë pa shpirtin e njeriut, pa njeriun vetë. Kësisoj, autori ka derdhur mbi varg shpirtin, njeriun e tij.

PUHIZË

Një puhizë po vjen nga deti bashkë me erë të trupit tënd
Mbi një pëndëz të shkëlqyer që valëvitet anë e kënd
Më sjell ca thërrmija gurësh të mbështjella në stërkalë
Sa të nanurisem pakëz e të dehem përmbi valë.

Një pulëbardhë më ndjek nga pas më këndon për dashuri
Pastaj më thërret në emër në mes diellit ngjyrë flori
Edhe zhduket aq vegimshëm pa lënë gjurmë e pa lënë hije
Saqë mbetem ngazëllyer i mbërthyer prej magjie.

Dhe përtej ca kaltërsive del sirenë prej thellësisë
Përshëndet me dorë të shtrirë më thotë rrugën e shtëpisë
E më sheh me sy përlotur plot dënesë edhe mëshirë
Pastaj hidhet përmbi dallgë ndërsa qiejt janë nxirë.

Si ta marr njëherë me vete gjithë kët quell të vendit tim
Ta bëj shtrojë edhe mbulesë a shami për pshëritimë
E të mbetem tulatur nën një dallgëz duke qarë
Sa të vijë tjetër puhizë të më njomë synë e përtharë.

PËLLUMBAT E MI

Kanë dalë pëllumbat përsëri,
krahë lagur edhe mjerë
E shkojnë e ulen mbi çati,
po presin ca të tjerë

Gugasin fort e shkundin pendë,
thërrasin zogjtë në fushë
Pastaj zënë puthen në një kënd,
me sqepatë në gushë

È nisën, marin udhë të gjatë,
kush di vallë ku të shpie
Andej matanë nga pusi i thatë,
kënetës në një hije

Ndaj u thërras me zë të butë,
më merni në mes resh
Andej të fshihem si hajdut,
bashkë me një pëllumbeshë

Andej ku zhukat hedhin gjëmb,
përkulur ndën marinë
Dhe gjurmët treten nënë këmbë,
sikur s'njohin njérinë

E ulen prapë krahëshkruar,
oborrit mbi plepishtë
Këndoja këngë për ne të dy,
e ngrihenë sérish...

TUFË ZOGJSH

Një tufë zogjsh e ndjek pas,
tek shkojnë bashkë në vëndin tim
T'ju them diçka por s'di të flas,
pse kurrë s'mësova cicërimë.

Ata më shohin të hutuar,
disa të tjerë plotë me habi
Ç'është kjo krijesë e dëshpëruar,
që nuk është zog e as njeri.

Se nuk e dinë shpendët e shkretë,
që mall të bën të fluturosh
Të kalosh mal, të kalosh det
pa kohë të shkuar edhe moshë.

Me krahë të zhveshura pa pëndë,
në dhëmbë një fjalë të mërmërirë
Paçka se zogjtë thonë është i pamënd,
paçka se zogjtë ndiejnë mëshirë.

SHELGU PLAK

Buzë lumit nën një shelg fshihem ditës deri vonë
E shikoj valët të rrjedhin poshtë shelgut që loton
Por përsenë u bë kaq kohë se kuptova, nuk e di
Ndoshta qan se është vetëm, ndoshta qan për dashuri.

Nën të fshihen ca hajdutë, nën të fshihenë dashnorë
Fshihen njërez të pashpresë edhe shpirtëra të gjorë
Numërojnë valën e turbullt tek shkon tej me qetësi
Edhe ndjekin hijë të rëndë gjersa bie errësi.

Nuk mësova kurrë njëherë se çfarë moshe ka vërtetë
Ish aty që në kohë tjetër ndoshta bëri njëqind vjetë
Buzë ujtrash që lodronin bashkë me degë të rënë mbi tokë
Sikur ishin miq të vjetër sikur ishin gjithmonë shokë.

I HUAJI

I huaj mbeta për të gjithë,
të zgjedh nuk ka kuptim
Për shokë të vjetër s'mbeti kohë,
e as për shokë të rinj.

Kush jam tashmë se di as vetë,
shyqyr që kam një emër
S'do kush ta dijë çfarë ke dëshirë,
ta dijë çfarë ke në zemër.

Këtu më njohin si fytyrë,
andej harrojnë me vrik
Ndoshta një vajzë kujtohet pak,
për djalin simpatik.

Ai që shkruante varg të ëmbël,
ku iku, kush e di!??
Ka vite që se kemi parë,
vërtetë ish zotëri.

Por si ti them vajzës së bukur,
me trupin bardhë borë
Ai djali që premtonte shumë,
tani bën shërbëtor.

E ndoshta brengë e vrau keq,
është bërë një gjysëm hije
Këndej se njohin se kush është,
andej ndoshta një fije.

Po ç'rëndësi ka jeta ime,
për jetën s'më vjen zor
Kështu u rrrokullisë punët,
me fatin djallëzor.

Prandaj kujtoj më mall çdo ditë,
kur nuk mendoja gjatë
Por bridhja fshatit i menduar,
bashkë me kalë mëzat.

Dhe shokë thërrisin që andej,
ku je Fatmir, do vish!??
Në breg të detit në dritë hëne,
a te selvitë në kishë.

E ndoshta prapë më thërrasin,
për mua ndezin qiri
I ndriftë zoti rrugë të kthimit,
pastë fat e dashuri.

LOKJA

Osman DEMIRI

Dhembla ka dy faqe, fillonte bisedën lokja, të dukshmen dhe të padukshmen. Dhemben e dukshme ta shohin të gjithë, dhe mundohen që secili në mënyrën e vet të tē ndihmojë. Dikush me fjalë, dikush me vepra tē bën tē ndjehesh pak më mirë.

Mirëpo, ka një lloj dhembjeje që askush nuk tē ndihmon dot. Jeta e saj ngjan me një film horror, me skena trishtuese dhe me plot të papritura. Qysh kur i kishte vdekur burri i parë dhe e kishin ndarë nga djali njëvjeçar, pér tē cilin më vonë kuptoi se ishte djegur në votrën e shtëpisë, jeta e saj kishte marr tatëpjetën. Një kohë tē konsiderueshme jetoi me prindërit dhe vëllezërit e saj. Pas disa vitesh e martuan me gjyshin tim. Burrë ode dhe kuvendi. Dalëngadalë lokja kishte filluar ta marrë veten. Lindi tre fëmijë dhe sapo filloj t'i gëzohej jetës, ajo e tradhroi prapë. Gjyshi im vdiq, duke e lënë me tre jetimë në një fshat në majë të malit. Mirëpo, ajo tanë nuk ishte vetëm, kishte tre fëmijë, vajzën gjashtë vjeçë, kurse djemtë njërin katër e tjetrin akoma pa mbushur dy vjet.

Ajo ishte edhe burrë edhe grua në shtëpi, deri sa ia rritën fëmijët. Vetë punonte tokën, vetë ruante bagëtinë, vetë siguronte drutë e dimrit. Fëmijët u rritën me shumë mund dhe sakrificë. Djalin e madh e martoja pa dasmë, kurse martaçen e djalit tē vogël e bëri me dy palë tupanë. Mbodhi gjithë katundin dhe farefisin e saj. Muzati më i mirë dhe katër desh tē majmë u therën dhe u poqën në hell. Dy vjet pas kësaj u shpërngulën në qytet.

Ne e njihnim loken e katundit vetëm nga tregimet e babës. Sharnia e bardhë si bora çdoherë i shkëlgente në kokë. Dimitë "shalie" dhe xhaketa, çdoherë në ton tē njëjtë, asnjëherë nuk lenin përshtypjen e një gruaje tē vuajtur, pér tē cilën na fliste -Katër vilazni i kam varrosë, i kam që dhe i kam vajtu. U kam shku te vorri dhe u kam këndu dova. Çdo bajram i kam vizitue, bisedojsja me ta, llaf muhabet dhe në fund nuk mundesha pa i pyet: Habibin, a ma keni pa? Asnjeri verë me gojë nuk bënte. Ndoshata bajramin tjetër, -ishin fjalët e shpeshta tē lokes. Vdiq në moshën tetëdhjetëtetëvjeçare, pa e marr përgjigjën pér vëllain e humbur. Ajo me vete mori vetëm dhembjen e padukshme tē saj. Dhemben, tē cilën thoshte se nuk ia ndjente askush.

baba. Gjithmonë e veshur dhe e hekurosur si në ditë festash. Nuk fliste shumë, por dégjonte vëmendshëm. Edhe pse jetonte me axhën, nuk dihej kurrë se ku e gjeje, ke ne apo ke axha. Ishte si urë lidhëse e dy shtëpive tona. Në dy shtëpitë tē cilat i ndante rruga, fjalë e fundin çdoherë ishte e saj.

Shpërnguljen nga fshati, ajo e kishte përfjetuar shumë rëndë. Edhe pse kishin marrë gjitha placat me vete, asaj i kishin mbetur kujtimet. Vellezërit që i vdiqën, kush nga lufta e kush nga mortaja, i kishte qarë dhe vajtuar shumë herë. Mirëpo kishte një peng të madh në zemër, vëllain që shkoi në luftë në Jemen dhe nuk u kthyte kurrë. Pér tē nuk dihej se ka vdekur, sepse kurrë nuk erdhë një lajm i tillë. Kjo ishte ajo dhimbja pér tē cilën nuk tē ndihmon dot askush. E priten me vite të téra dhe të gjithë u pajtuan me humbjen e tij, përvëç lokes, e cila nuk u pajtua kurrë me këtë fakt. Ajo e priste. Çdo trokitje e derës apo sa herë binte zilja, ajo ngrinte kokën me shpresë. Shumë herë i thoshin se duhej tē kishte vdekur, ndryshe nuk sqarohej humbja e tij, por lokja nuk pranonte. Shpesh e gjenim duke folur me tē, sikur ta kishte pranë. Kur e pyesnim se me kë fliste, ajo thoshte se po çmallej me vëllain, se edhe atë e paska marrë malli.

-Katër vilazni i kam varrosë, i kam që dhe i kam vajtu. U kam shku te vorri dhe u kam këndu dova. Çdo bajram i kam vizitue, bisedojsja me ta, llaf muhabet dhe në fund nuk mundesha pa i pyet: Habibin, a ma keni pa? Asnjeri verë me gojë nuk bënte. Ndoshata bajramin tjetër, -ishin fjalët e shpeshta tē lokes. Vdiq në moshën tetëdhjetëtetëvjeçare, pa e marr përgjigjën pér vëllain e humbur. Ajo me vete mori vetëm dhembjen e padukshme tē saj. Dhemben, tē cilën thoshte se nuk ia ndjente askush.



Delmore Schwartz

POETI

Pasuria e poetit është e barabartë me poezinë e tij
Fuqia e tij është dora e tij e majtë
Ajo është përtace e ngadalët dhe e vyer
Skamja e tij është pasuria e tij, pasuri që mund ta shkatërrojë atë
si Mida
Sepse ajo përtaci është njëfarë forme e padurimit
Dhe nga kjo ai mund të mund tē shkatërrohet nga ari i drtitës
që nuk ka qenë kurrë
Në tokë apo nē det.
Ai mund tē jetë i dehur pér vdekje, duke shterur fuçitë e teprisë
Atë formë ekstreme tē suksesit.
Ai mund tē pësojë fatin e Narcisit
I paaftë pér tē jetuar përvëçse me imazhin që është dalldi
Dashuri, e verbër, e adhuruar, e tejmbushur
I paaftë pér t'iu përgjigjur çdo gjë që nuk sjell dashuri
shpejt ose menjëherë.

...Poeti duhet tē jetë i pafajshëm dhe injorant
Por ai nuk mund tē jetë i pafajshëm pasi budallallëku nuk është
pika e tij e forte
Prandaj Cocteau ka thënë: "Çfarë nuk do tē jepja
Të tërhojnë nga ekzistanca poezitë e rinisë sime?
Unë do t'i jepja Satanit shpirtin tim tē pavdekshëm."
Kjo metaforë është e gabuar, sepse ishte shpirti i pavdekshëm
që ai dëshironë tē shëlbonte,
Duke e ngritur dhe duke e shoshitur atë, tē lirë dhe tē bardhë,
nga aktualiteti i banalitetit, vulgaritetit tē rinisë,

pompoziteti dhe shtirja e veprave tē tij tē hershme poetike.

Po ashtu nē tē njëjtën mënyrë një Poet i Farmshëm amerikan Kur fama i kishte ardhur më nē fund, i kërkonte pesëdhjetë kopjet e librit tē tij tē parë me poesi, tē cilin e kishte shtypur privatish me shpenzimet e veta.
Ai arriti tē sigurojë 48 nga 50 kopjet, i dogji
Dhe pastaj kishte kuptuar se si ekzistuan kopjet e fundit,
Siç e kërkonte ligji i vendit, tē fshehura nē kryeqytet,
në Bibliotekën e Kongresit.
Kësht që, ai shkoi në Uashington, dhe aty i mori dy kopjet e fundit
I futi nē xhepin e tij, planifikoi tē largohej
Ama e ndaluan dhe e arrestuan. Meqenëse ai ishte autor,
Dhe meqë ato ishin librat e tij dhe pronë e tij, e qortuan
Por e falën. Ama dy kopjet ia morën
Duke krijuar kështu një precedent kombëtar.

Sepse as arnnisti, as falje nuk u jepet poetëve, poezi së dhe vjershavë,
Ngase William James, gjenu i dashur i Harvadit
tha tē vërtetën tmerruese: "Miqtë e tu mund tē harrojnë, Zoti
mund tē tē falë, por qelizat e trurit regjistrojnë
veprimet e tua deri nē fund tē përfjetësisë."
Çfarë gjëje e tmershme pér tē thënë!
Kjo është gremisi e pafund, pa kurrfarë ilaçi, e poezi së.
Ky është po ashtu edhe gëzimi i përfjetshëm i poezi së.

DEKODIMI I METAFORËS SË "HESHTJES" DHE "HUMBJES"

Poezia "Përpara Tomorit" (telegraf: 3 prill, 2014), u vlerësua me çmimin e parë në konkursin letrar, që u shpall më 1 janar 1942, kur ishte 22-vjeçar



Emri KROSI

Në tekstet letrare, kriteri i përdorimit për interpretimin, në përpunje me kohën kur është shkruar, futet në lojë teoria e receptimit (Iser: 1974: 85) dhe pritja e grupeve të ndryshme të lexuesve, por në kohë të ndryshme. Prandaj, nuk ka asnjë perceptim të vetëm të paracaktuar adekuat të një teksti të caktuar, në të cilin teoria letrare duhet të fokusohet, në vend të kësaj, të gjitha pritet aktuale në të kaluarën dhe të tashmen janë të vlefshme, si pikëtakim mes brezave të lexuesve. Vepra e hershme ka dy pole: atë estetik dhe artistik. Artistika i referohet tekstit të krijuar nga autori dhe estetikja, realizimi të realizuar nga lexuesi. Në drithë e këtyre fakteve të teorive letrare, vjen edhe poeti, përkthyesi nga letërsia orientale i "humbur" dhe i "penguari", Vexhi Buhara, si një ndër njohësit më të shquar të fushës së orientalizmit (Kondo: 1995). Shumë vonë është njohur si poet, por më shumë si përkthyes i "Gjylstanit" të Saadiut dhe "Shah-Nameja" e Firdeusit etj.

Pas një heshtjeje të gjatë, në mesin e poetëve të viteve '30 -të, spikat edhe një emër tjetër më shumë si një përkthyes dhe njohës i orientalizmit, por edhe si poet, Vexhi Buhara një poet i dashurisë për njeriun e bukuritë e natyrës shqiptare (Dëshnica: 2020). Poëzia e tij kishte një ngjashmëri me strukturën poetike dhe vargore të Lasgush Poradecit. Poëzia "Përpara Tomorit" (telegraf: 3

prill, 2014), u vlerësua me çmimin e parë në konkursin letrar, që u shpall më 1 janar 1942, kur ishte 22-vjeçar.

Bukuri këputur qiejsh mbi Tomorin sonte bie,

Më pushton që prej së largu dhe një shpirt prej lashtërie,

Si shkëndi, si rreze dielli, po afrohet valë -valë,

Ndënëqesh me mall të nxehur pastaj hapet me ngadalë,

Edhe zbut si yll i ndezur ku shkon jeta në mjerime:

Gjer në fund të natës sime.

Dhe kjo dritë dhe kjo flakë që po ndez një qell floriri,

Që po qesh nga majë malit si një diell ndaj të gdhirë,

Gaz' ilar' me drit' thëngjilli që pikoi vetveti

Edhe gaz' i Afërditës që së lartësh vetëtiu

Nga dy buz' si trëndafili edhe ra në embëlsime:

Gjer në fund të natës sime.

Zog' i shpirtit tundi krahët mbi Tomorin fluturoi!

Shpuzë e mallit po valëvitet, trete helmin, ligjëro!

Thuaja si ia thot' bariu kur dëgjon zën' e gugashit

Shko si shkon syr' i gjahtarit nëpër udhën e larashit,

Qesh si qesh një shtizë hënë përmbi faqen e dëborës,

Ndrin si ndrin një fije ari mu në buzën e kurorës

Dhe këndo posa bilbili me aq mall e drithërimë

Gjer në fund të ditës sime.

Dhe pasi të kesh marrë, frym' e

shpirt nga bukuria

Dhe pasi të kesh parë, ca shkëndi nga dashuria,

Fute kokën ndënë krahë dhe dëgjo, o pendëshkruar,

Sesi nga Osumi i jetës, buçet këng' e amëshuar.

Si buçet nga goj' e Zotit Fjal' eëmbël mençurie,

Si buçet nga buzë e Muzës fjal' eëmbël bukurie,

Si buçet nga gjit' e vashës fjal' e zjarritë dashurie...

Del nga fund' i fshehtësisë sipër valëve të lumit,

Dhe përhapet anembanë sa na zgjon nga nat'e gjumit

Pastaj ngjitet lartë -lartë ku ndez jeta në shkëlpime:

Gjer në fron të ditës sime

Ndërtimin e poeziës poeti e bazon mbi përshkrimin e natyrës dhe vargu: gjer në fund të natës sime, përsëritet rrëth katër herë (4), por në vend të togfjalëshit: ([të natës time] është zëvendësuar me toqun tjetër emëror [të ditës sime]). Ky lloj zëvendësimi është i qëllimshëm nga poeti, sepse motivet e përshkruese fillojnë me shkallëzimin ngjites deri në Malin e Tomorit, pastaj shkallëzim zbritës deri tek elementi humor Osumi. Ndërthurja e elementeve mistike me elementet letrare: si buçet nga goj' e Zotit Fjal' eëmbël mençurie dhe vargu: si buçet nga buzë e Muzës fjal' eëmbël bukurie, vjen përmes këtyre komponenteve:

përshkrimi plot pasion i natyrës,

përpjessëtimi përmes pangopësise dhe subjektivizmit poetik,

krijimi i kontrasteve të natyrës përmes imaginatës,

"nota trishtimi" përmes bukurisë natyrore dhe mëdisëse baritore, kompozimi dhe ndërtimi i imagjinatës poetike-realiste,

përvojat e jetës rutinë dhe natyrës së përditshme.

Ndërtimi i vargut (AA/BB) dhe aspekti natyrore si një aspekt i vizioneve kriptike (Fraj: 1990: 148), kanë mbutur jashtë imtimeve përmes simboleve të komunikueshme. Vargjet: bukuri këputur qiejsh mbi Tomorin sonte bie./Më pushton që prej së largu dhe një shpirt prej lashtërie./Si shkëndi, si rreze dielli, po afrohet valë -valë./Ndënëqesh me mall të nxehur pastaj hapet me ngadalë./Edhe zbut si yll i ndezur ku shkon jeta në mjerime:/Gjer në fund të natës sime, ku përshkrimi i natyrës, nuk është mirazh, por trop mataforik që zbulohet që në vargun e parë: [bukuri këputur qiejsh]. Në këtë rast, nuk mund të "mendojmë" përnjë avancim "figurativ të ligjërimit", por do të thotë të krijosh vepra që nuk refuzojnë standardet e pranuara nga shumica (Porter: 2002: 117). Vargjet: zog' i shpirtit tundi krahët mbi

Tomorin fluturoi!/Shpuzë e mallit po valëvitet, trete helmin, ligjëro!/Thuaja si ia thot' bariu kur dëgjon zën' e gugashit/Shko si shkon syr' i gjahtarit nëpër udhën e larashit, poeti ka ndërtuar përsëri trope metaforike si [zog' i shpirtit], duke rrokat [vertikalitetin =Tomori + Qielli]. Kanodohur një përmysje me një kuptim të parë, ku organizimi semantik por edhe semantika strukturale, krijojnë ndërvarësi mes njëra-tjetrës, mund "të kuptojmë" lidhjen praktiko-estetike të njeriut me mjedisin. Në vazhdimësi: dhe pasi të kesh marrë, frym' e shpirt nga bukuria/Dhe pasi të kesh parë, ca shkëndi nga dashuria,/ Fute kokën ndënë krahë dhe dëgjo, o pendëshkruar./Sesi nga Osumi i jetës, buçet këng' e amëshuar, tashmë kthehet në [horizontalitet = Osumi + Tokaj lidhja e elementeve planetare, me botën natyrore, ngjiz edhe kombinimin folozofik, në nivelet figurative si:

a) makrosemiotikës,

b) ektrasemiotikës, si një kuptim më të thellë përmes perceptimeve të botës natyrore (Dombroski: 1996: 506). Përmes strategjisë interpretuese të leximit të vargjeve: si buçet nga goj' e Zotit Fjal' eëmbël mençurie,/Si buçet nga buzë e Muzës fjal' eëmbël bukurie,/Si buçet nga gjit' e vashës fjal' e zjarritë dashurie.../Del nga fund' i fshehtësisë sipër valëve të lumit, poeti përmes kodeve të komunikimit, mistika rroket me katër elementet jetësore (uji+ Osumi= pastrimin e mëkateve), se vetë Muza si femër e dashuruar përmes elementeve romantiko-sentimentale, se poezitë e Buharasë qenë struktur në atë kohë brenda burgut të fondit të rezervuar (Hima: 2008). Portretizimi edhe përmes personifikimit, ku poeti i drejtobet natyrës, qillit të natës edhe si cilësi njerëzore. Poeti, sugjeron se e vërteta për ekzistencën mund të vërehet në natyrë dhe ai dëshiron të jetojë në të, për të gjetur të vërtetën dhe për të kërkuar e dëshmuar vetë këto përgjigje.

Si përfundim: poëzia e Vexhi Buharasë, nuk ndryshon nga poëzia e bashkëkohësve të tij, ku mbisduan elementet e përshkrimit të natyrës dhe ato romantike, por edhe sentimentale, që përfaqëson edhe ajo periudhë letrare e kohës. Përveçse si poet, Buhara njihet si përkthyes nga gjuhët orientale (persisht, osmanisht, turqisht, arabisht) duke na lënë një trashëgimi të madhe poetiko-kulturore të panjohur më parë dhe të harruar edhe nga studiuesit dhe kritika, që padyshim do të quhet edhe një "imitues" i Poradecit. Por, risia dhe individuizmi i tij lidhen edhe me kulturën mistike të poetëve persë që dallohen, për lidhjen mes mistikës, natyrës dhe dashurisë.

ARKITEKTURË E MREKULLUESHME POETIKE

Veçantia e L.Poradecit pikërisht është intuita poetike që ju mungon poetëve tjerë. Shkalla më e lartë e poeziës së Lasgushit është INTUITA që është shkallare e vetëdijes poetike

Sulejman MEHAZI

1. Përgjithësisht poezië e Lasgush Poradecit që nga dheri, lijeri, Poradeci, e më lartë, "Zogu i qjellit, Nositi deri në lartësinë më të lartë të jetës, vdekjes e përfjetësisë mund t'i ndajmë në tri shkallë poetike:

- shkalla e intelektit poetik;
- shkalla e instinktit poetik;
- shkalla e intuitës poetike.

1.1. Shkalla e intelektit poetik ka të bëjë me të menduarit imaginativ:

"Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar, ç'na buron nga mal, duke mërmëruar Venë e mbushin ujë vashat anembanë cipëzën me hoja lidhur mënjanë; Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe, gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe."

Apo:

"Kroi i fshatit tonë, ngjyr' ergjend i lyer që nga rrëz' e malit ç'na buron rrëmbyer. Venë e pinë ujë trimat anembanë takjen me lule, përrmbi sy mënjanë. Takjen e dli, takjen e nxirrë Buzën në të qeshur... më të pshëretirë..."

1.2. Shkalla e instinktit poetik ka të bëjë me dëshirën, epshin e lakmës dashurore:

"E si mbushin ujë, bubu ç'm'u ka hije, ndaj kthehen prap me hap nusërije ndezur yll i ballit si yll shenjtërie."

Apo:

"Mbrëmave kur uji mërmëron nga-dalë, vjen t'i thotë trimi vashës një dy fjalë: Vashëzën bujare që po vin në krau Siç' përshtëndeta, siç'm'u turpëra Papu ula kryet e shikova si grua"

1.3. Shkalla e intuitës poetike e cila është shkalla më e lartë e Vetëdijes poetike lasgushiane që e ka kuptimin e zemrës, dashurisë dhe poeziës:

"E si mbushin ujë, bubu ç'm'u ka hije, ndaj kthehen prap me hap nusërije ndezur yll i ballit si yll shenjtërie."

Apo:

"Kroi i fshatit tonë, n'atë mal me fletë, derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë pos malli i zemrës mu në gjithë shkretë Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë, pos malli i vashës, që djeg në të fshehtë, pos malli i trimit, që buçet përfjetë, obobo, si malli, që nuk vdes përfjetë"

Pra, Lasgush Poeadeci te "Kroi i fshatit tonë" ka përdorur tri shkallët e patjetësueshme poetike:

-intelektin, instinktin dhe atë më kryesoren intuitën poetike. Veçantia e L.Poradecit pikërisht është intuita poetike që ju mungon poetëve tjerë. Shkalla më e lartë e poeziës së Lasgushit është INTUITA që është shkallare e vetëdijes poetike.

Kjo VETËDIE INTUITIVE poetike, pastaj ndahet në tri nënpjesë përshkallare:

-e para, më e ulëta, fizika, e dukshmja, njëzorja është INSTINKTI;

- e dyta, e mesit, është INTELEKTI;
- e treta, më e larta është INTUITA.

Pra, shkallaret poetike në poezinë e mrekullueshme "Kroi i fshatit tonë" janë: instinkti, intelekti dhe intuita që kanë të bëjnë e janë të lidhura me tri pjesë përbërëse

poetike: me materien, natyrën, fiziken-trupin; me mendjen, intelektin-dijen dhe me zemrën, dashurinë, poezinë.

- Instinktet poetike kanë të bëjnë me trupin lakkues e epshor të poetit;
- Intelekti me kokën diturake të poetit;
- Intuita me funksionin e zemrës së ndritur të poetit.

2. Elementet e të kuptuarit të poeziës: "Kroi i fshatit tonë"

- Të kuptuarit me mendje;
- Të kuptuarit me traditë;
- Të kuptuarit, shijuarit me zemër;
- Të kuptuarit me kulturë të thellë.
- Të kuptuarit me lexim.
- Kulmi i të kuptuarit është ekzaltimi me tërë veten dhe qenien e Lasgush Poradecit.

2.1. Llojet e delikatesës/hollësise poetike te "Kroi i fshatit tonë"

- Delikatesa e syrit;
- Delikatesa e zemrës;
- Delikatesa e ndjenjës;
- Delikatesa e shpiririt;
- Delikatesa e bukurisë;
- Delikatesa e dashurisë
- Delikatesa në tërë vargjeve poetike!

2.2. Llojet e motive poetike të poeziës "Kroi i fshatit tonë"

- Motive të bazuara në traditën;
- Motive të bazuara në të ardhmen;
- Motive lidhjesh midis shkakut dhe pasojës;
- Motive dashurore;
- Motive shpresash jetësore;
- Motive faktesh dhe provash.

2.3. Llojet e të pamurit perceptuese-estetike te "Kroi i fshatit tonë"

- Shikime apo perceptime estetike me anë të syrit;
- Shikime e perceptime estetike idesh;
- Shikime e perceptime estetike me anë të zemrës;
- Shikime e perceptime estetike ndjenjash;
- Shikime e perceptime estetike shpirtore;
- Shikime e perceptime estetike me kuptime figurash e metaforash;
- Shikime e perceptime estetike me tërë veten e poetit në vargjet poetike.

2.4. Llojet e dashurisë në "Kroi i fshatit tonë"

- Dashuria me mendje;
- Dashuria me shpir;
- Dashuria me zemër;
- Dashuria me ego;
- Dashuria me besnikëri;
- Dashuria me tërë veten apo qenien e poetit, Lasgush Poradecit.

2.5. Llojet e bukurisë në "Kroi i fshatit tonë"

- Bukuria e natyrës;
- Bukuria e traditës;
- Bukuria e veshjes;
- Bukuria e zemrës;
- Bukuria e mendjes;
- Bukuria e ftyrës;
- Bukuria e fjales;
- Bukuria e ndjenjës;
- Bukuria e dashurisë;
- Bukuria e vargut;
- Bukuria e metaforës;



VIZIONI I HERMETIZMIT

William Blake duket sikur i jep një tjetër dimension asaj frazës së famshme latine: **Homo faber fortune sue - njeriu ndërton fatin e vet.** Pas leximit të Plisit dhe gurit të zallit ndryshon edhe perceptimi ndaj kësaj fraze, që të lë me më tepër dyshime

(Hamdi) Erjon MUÇA

Proza kishte mbi njëmijë vjet që ekzistonte si zhanër, e megjithatë poetika ishte këmbëngulëse në këtë mision që si zanafillë ishte i veti, por që për nga natyra e sajë (pjellë e sinopseve abstarke të mendimit njerëzor) nuk mund dhe nuk duhej ta mbante shumë gjatë mbi shpatulla. Mes rrëfimeve prozake antike, apo edhe pos-antike dhe atyre poetike deri në portat e klasicizmit, kishte një ndryshim të madh; proza e drejtëpërdrejtë, hera-herës e vrashdë, ashtu si etapat realistike të rrëfimit, ndërsa poetika, e ëmbël, e brishtë, e mbushur plot me metafora, krahasime, me nënkuptime, në kërkim të vazhdueshëm të sublimit të gjuhës; me të njëjtin ritëm, konstant, që nga Suplicet e Eskilit apo Bakantet e Euripidit, tek Eneida e Virgilit apo Lesbia e Catullo-s, duke kaluar tek Komedia hyjnore e Dantes apo Orlnado i furishëm e Ariostos, deri te Parajsa e humbur e Milton-it apo Endimione i Keats, por me një kryq të rëndë mbi kurriz në këtë udhëtim mijëvjeçarë. Vetëm me William Blake-un do të përballemi me largimin e poeziës nga kalvari i mbartjes së historive. William Blake ishte i pari që poezinë nga universi e ktheu në atë çka me të vërtetë është; në krijuesen e univerzeve. Ajo shkëndija parësore, që duhet të jetë shfaqur në çastin e big bang-ut, jo shpërthimi i madh, por xixa që parapriu shpërthimin; sinopset abstrakte të mendjes janë ato forcat e kaosit që përgatitën atmosferën për krijimin e xixës, xixa është poezia, dhe shpërthimi i big bang-ut janë moria e mendimeve që merr jetë pasi përballesht me një poezi. Pra, nuk duhet të jetë poezia që rrëfen, rrëfimin duhet ta bëjë lexuesi brenda vetes, poezia duhet vetëm të ndezë dritën e fantazisë; dhe sa më tepër rrëfime të ketë brenda një poezie, aq më e fuqishme është xixa që ajo mbart.

Wlliam Blake ishte krijues do si do, ai ishte një krijues poliderik, piktor, poet, filozof, megjithëse kjo e fundit maskohej ndër krijesa poetike të artit të fjalës dhe artit viziv. Mund të themi pa hamentje që poetika e tij ishte e mbushur me shumë vizione dhe piktura e tij mbante shumë poetikë dhe të dyja bashkë ishin të veshura me filozofinë e asaj xixës fillestar. Konkretisht kemi zgjedhur këtë poezi nga libri Kangët e pafajësisë dhe kangët e eksperiencës. Që në titull poeti është vizonar dhe ambig: Plisi dhe guri i zallit. Që të dyja janë objekte të këtij rruzulli, që të dyja kanë po të njëjtë përbërës, por njëri është në një gjendje ndry-



shueshmërie të shpejtë, ndërsa tjetri jo. Njëri, mund të thuhet, se është në një gjendje (për aq sa njohuri kemi mbi zanafillën e gjithçkaje) thuajse primitive, ndërsa e dyta, duke kaluar përmes një sërë faktorëve evolutiv është ngurtësuar, duke u kthyer në një kriesë refraktare.

"Dashuria nuk kërkon vetëm kënaqësinë e vet,

Dhe ndaj vvetes nuk ka asnjë ngutje,

por të mirën e vet i jep tjetrit, e krijon një pariz
në dëshpërim të ferrit".

Kjo strofë më tepër të jep përshtypjen e një lloj sentence filozofike thuajse pozitiviste. Mbart frymën e rrëfimit të diçkaje plotësish dhe qartësish të drejtëpërdrejtë. Vetëm se duhet të lexohet strofa e dytë për të kuptuar ambiguitetin e strofës së parë.

Një plis prej Argjile të shkelur nga këmbët e bagëtive këndoi këtë,

por një gurë zalli që ndodhej brenda përroit,

në këtë mënyrë vjershën ia ktheu:

Pra ky nuk ishte një rrëfim, por vizioni, se si, ajo kriesa primitive, e shkelur sa e sa herë në jetën e vet nga këmbë bagëtish, që e kanë bërë të ndryshojë formë në vartësi të këmbëve, e tharë nga dielli, por paraqitur të evoluojë në një gur zalli, e lagur nga shiu, si për t'ia bërë gati këmbës së radhës, që do ta shkelë,

për t'i dhënë një tjetër formë, është pozitiviste, beson tek e mira, tek shpërblimi i përjetësisë, në dëshpërim të këtij kalvari shkeljesh tokësore, madje as nuk e kujton se sa herë ka ndryshuar formë përgjatë jetës së vet. Mbetet optimiste, shpresuese për të ardhmen dhe as që e mendon se sa këmbë të tjera do ta shkelin; do të shkelet, thahet dhe ngurtësitet, laget dhe qullet për t'u bërë gati për shkelje të reja, përvijimisht. E ndërsa ti si lexues je duke rrëfyer historinë tënde nën diktatin e kësaj xixe, vjen strofa e tretë, për ta plotësuar sfondin e këtij vizioni.

"Dashuria kërkon vetëm kënaqësinë e vet,

e kësaj kënaqësie një tjetër kërkon t'i lidhë,

e lumtur edhe nëse tjetri humb mirësinë,

e për inat të parizit krijon një ferr".

Shfaqet ajo kriesa e evoluar, por që mesa duket edhe ajo është vetëm një pjesë e diçkaje shumë më të madhe; këtë gur zalli kushtet atmosferike e kanë shkëputur nga një shkëmb më i madh, i cili më parë që shkëputur nga mali, dhe lumi e ka rrokuallisur duke e përplasur me të tjerë gurë zalli, duke e larë dhe lëmuar. Edhe te kjo kriesë mund të bësh ndryshime, por për t'i bërë ato duhet të ushtrosh një forcë më të madhe dhe ato gjurma do të mbeten më gjatë të shënuara mbi të. Kjo kriesë e "evoluuar" e vështiron realitetin pa ambiguitet. Nuk gjen asnjë përfundim të dytë, qoftë edhe tek ajo ndjesi, që ne njerëzit e

kemi quajtur dashuri. Tek gjithçka, kjo kriesë ndjen egoizmin, që thënë kështu duket si diçka e ndyrë, ngaqë mijëra vite predikim mbi këtë ndyrësi, na kanë bërë ta ndjejmë të tillë, por që po ta vëzhgosh universalisht nuk është aspak ashtu. Dielli nuk digjet ngaqë duhet të ngrohë tokën që jeta të vijojë; ai duhet të djegë gazrat e veta të ndezura, e as që i bëhet vonë nëse njerëzit kanë ngrohtë apo të ftohtë. Jupiteri që përthith asteroidë, nuk e bën këtë ngaqë falë kësaj shpëton jeta mbi këtë planet, thjeshtë dendësia e tij prej dielli të munguar e bën më magnetik ndaj trupave qiellor. Së fundmi, ai big bang-u fillestar nuk u krijua që ne, sot, pas miliarda vitesh, sipas llogarive njerëzore, të shkruajnë këto radhë mbi një nga poetët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, u krijua sepse masat kaotike kishin mbërritur në pikën e duhur.

Vetëm se kriesa njerëzore, gjendet në dy zhvillime njëkohësisht; primitivisht e evoluuar, ose një evolucion primitiv perpetum. Ndoshta, sepse ndryshe nuk do të kishte jetë mbi këtë planet, që duhet të ketë më shumë plisa argjile që të ndryshojnë sa herë ia japin mundësinë kushtet atmosferike, se sa gurë zalli, thuajse të pandryshueshmë. Me anë të kësaj xixe poetike, William Blake duket sikur i jep një tjetër dimension asaj frazës së famshme latine: **Homo faber fortune sue - njeriu ndërton fatin e vet.** Pas leximit të Plisit dhe gurit të zallit ndryshon edhe perceptimi ndaj kësaj fraze, që të lë me më tepër dyshime. Njeriu ndërton fatin e vet?!. Kthehet njëhershëm në pyetje, në konstatim dhe në habi.

PLISI DHE GURI I ZALLIT

"Dashuria nuk kërkon vetëm kënaqësinë e vet,

Dhe ndaj vvetes nuk ka asnjë ngutje,

por të mirën e vet i jep tjetrit, e krijon një pariz

në dëshpërim të ferrit".

Një plis prej Argjile të shkelur nga këmbët e bagëtive këndoi këtë,

por një gurë zalli që ndodhej brenda përroit,

në këtë mënyrë vjershën ia ktheu:

" Dashuria kërkon vetëm kënaqësinë e vet,

e kësaj kënaqësie një tjetër kërkon t'i lidhë,

e lumtur edhe nëse tjetri humb mirësinë,

e për inat të parizit krijon një ferr".

SIRENAT NË APOLLONI

Një tjetër figurë që trajtohet dhe që është shumë e përhapur në kapitelet e kishave të Europës Perëndimore është dhe ai i sirenës

E veçanta në territorin e Shqipërisë është se sirenat paraqiten me flokë të shkurtra. Ndoshta kjo ka të bëjë me faktin se sirenat trajtohen si një figurë femërore epshndjellëse, ndërsa këtu autorë ka dashur të tregojë dënimin e grus që ka kryer mëkat, pasi në mesjetë gratë të cilat akuzoheshin për kryerjen e mëkatit të epshit u priteshin flokët. Kujtojmë se në vendet e tjera është paraqitur një model tjetër sirenë me flokë të gjata por dënim i saj simbolizohej me anë të gjarpërinje që sulmonin gjintë e saj. Fakti që sirenë e Apollonisë nuk është në vendosje ballore por e paraqitur në profil tregon se ky kapitet është i shek. XII, dhe është ripërdorur. Gjithashtu, në kapitelin tjetër të kishës është paraqitur një çift të cilët janë trajtuar në mënyrë shatazore. Figura e mashkullit paraqitet sipër femrës dhe ka të ngjarë të tregojë mentalitetin e banorëve mesjetar për seksin.

Në muret e shtimeve të Manastirit gjenden biloqe gurësh në të cilët skallit skena të shumta. Në një prej tyre shohim të paraqitura figura të shumta njerëzish dhe kafshësh së bashku. Dy prej figurave njerëzore kanë në kokën e tyre kapele dhe brirë ndërsa mbajnë peshë një figure të tretë mashkullorë i cili ka në kokë një kurorë. Këto figura ndoshta simbolizojnë hebrejnët si ndjekës të antikrishtit dhe si tradhtaret të Krishtit të cilët blasemonin me figurën e tij. Gjithashtu një tjetër figurë po më të njëjtin bllok ka hipur në një gomar ndërsa një tjetër, duke kryer marrëdhënien me kafshë. Të gjitha këto tregojnë përmes mentalitetin që ekzistonte në Mesjetë për hebrejnët, për akuzat që u atribuohen në atyre dhe hamendësimet për incest dhe zoofili. Ndërmjet figurave me karakter erotik kemi dhe skulptura, të cilat gjenden afër tyre, por nuk janë nën kontekstin erotik, p.sh. ojo e një çifti me trup zogu që për nga pamja duken aristokratë. Këta ndoshta simbolizojnë tempullarët, urdhëri i cili u themelua përmbrrojtjen e pelegrinëve në Tokën e Shenjtë. Urdhri shumë shpejt arriti të shndërrohej në një organizatë të fuqishme dhe ndosha sekreti i fuqisë së tyre i dedikohej sepse ata përvetësuan sekrete të misticizmit mysliman. Për këtë urdhri u akuzua për bashkëpunim me armikun, imoralitet dhe pavarësisht akuzave që u detyruan të pranojnë nga inkvizitorët, nuk ka dyshim se mes anëtarëve të urdhrit kishte diferenca moshe dhe kohëzgjatjeje në urdhër dhe anëtarë më i ri duhej t'i nënshtrohej dëshirave të atij më të vjetër.

Një tjetër fakt me interes është se në territorin tonë nuk kemi ndeshur ende të trajtuar në skulpturë figurat e akrobatëve apo dhe figura të tjera të trajtuarë në mënyrë magafalike në mesjetë. Kjo ndoshta nga fakti se në vendin tonë gërmimët arkeologjike janë të përqendruara kryesisht në monumentet e Antikitetit të Vonë dhe shumë pak në ato mesjetare. Shpresojmë në të ardhmen të kemi më shumë gërmimë dhe në këtë fushë

dhe njëkohësisht më shumë përgjigje. Duke e trajtuar në periudha të ndryshme, erotizmi ka marrë trajta të ndryshme. Erozizëm në art vërejmë që në prehistori me figurinat antropomorfë me paraqitje të hapur të anatomisë trupore dhe pjesët gjinore të trupit të ekzagjeruar. Të ashtuquajturat venuse, të cilat datojnë në Paleolit e Lartë gjunjë një përhapje të gjerë nga Europa perëndimore deri në Siberi dhe në gjithë këtë hapësirë janë trajtuar pothuajse më të njëjtën mënyrë. Paleoliti ka shumë tregues të paktë të paraqitjes së figurës mashkullorë dëshrmues i pozitës inferiore të mashkullit.

Në neolit dhe në periudhën e bronzit kemi vazhdimësi të paraqitjes së femrës në figurinat antropomorfë por kemi dhe paraqitjen e mashkullit i cili tashmë në shoqërinë neolitike kishte përforuar pozitat e tij. Ndërsa në bronzin e mesëm figurinat antropomorfë bëhen më të rralla derisa në periudhën e hekurit nuk kemi më dëshmi të tyre. Në periudhën antike arti merr impulse të reja. Në Greqinë e lashtë kemi të bëjmë me erotizëm të nënkuptuar pasi statujat të cilat prej së shumti paraqesin shërbëllityra në dukje të realizuara në mënyrë natyraliste shoqërohen nga një numër i madh mitesh, vargjesh poetësh dhe legjendasht të cilat i fusin personazhet e statujave në një kontekst erotik. Gjithashtu, atributet dhe sjelljet që u jepeshin përendive simbolizonin dhe dëshirat e vërteta të shoqërisë athinase. Kryesisht në periudhën klasike të artit grek kemi trajtimin e disa prej përendive në mënyrë erotikë dhe këto janë figura e Afërditës, e Dionisit, e Hermesit e Panit dhe e Priapit. Dhe në territorin tonë në periudhën antike gjenden figura të shumta falike në të cilat paraqitet hyu i pjellorisë e trajtuar si figure megafalike

Në periudhën romake erotizmi del hapur dhe krahas skulpturave dhe piktureve të realizuara me realizëm ka dhe të tjera të cilat janë trajtuar në mënyrë megafalike. Shembull i kësaj janë afresket e Porneit dhe veçanërisht të Lupanares, të cilat pasqyrojnë skena e përfundimit të zhvillimit të shërbimet që ofronin, qoftë për të rritur ndjenjën e kënaqësisë tek klientët. Në periudhën e Mesjetës arti zhvillohet kryesisht në gjirin e Kishës. Impulset dhe shembujt e artit mesjetar u morën nga periudhat e mëparshme, nga shembujt e artit greko-romak dhe u trajtuan nga artistët romaneskë në mënyrë megafalike. Arti mesjetar ishte art didaktik dhe si i tillë synonte t'u tregonte banorëve mesjetar se ata ishin përgjegjës të veprimeve të tyre dhe se në bazë të këtyre veprimeve do të gjykoheshin. Erozizmin në Mesjetë e gjejmë të skalitur në muret dhe në kapitelet e kishave më të mëdha të Europës perëndimore ndërsa në territorin tonë përfaqësuese është Kisha e Manastirit në Apolloni.

Profile

MARK TUEIN, AUTORI I "AVENTURAVE..."

Mark Tueini është nga ajo tipologji shkrimtarësh, me të cilin lexuesi ynë shqiptar ka hyrë në dialog që në fëmijërinë e tij, nëpërmjet romaneve të mrekullueshëm, si: "Aventurat e Tom Sojerit", e "Aventurat e Hakëlberi Finit" etj

Xhahid BUSHATI

Mark Tueini qe fëmija i gjashtë i Xhon Marshallit dhe Xhejn Lampton Klemensit. Kur Samuelli ishte katër vjeç, familja e tij vendoset në qytetin e vogël Habibë(a), buzë lumi Misisipi. Qyteti buzë lumi i ngjan Samuelit të vogël me një vend përrallash. Së bashku me shokun e tij të fëmijërisë, Tom Blakënshipin, të birin e një pijnaceti të varfér, të cilin e bëri më pas të pavdekshtëm me romanin "Aventurat e Hakëlberi Finit", ata kurdisin plot lojëra e aventura, ku hiqen si Robin Hudë e herë si piratë. Romantika dhe ashpërsia e jetës në lumë, avulloret e trapet, heroizmi i punëtorëve të varfér, që punojnë, mundohen e stërmundohen aty, i lënë mbreso të thella e të pashlyeshme Samuelit. Kjo mbresë e pashlyeshme, vite më vonë, shkrimitari do t'i kthehet në shqetësim përvëllës, ku në "Aventurat e Hakëlberi Finit", një roman realist, por jo vetëm në këtë vepër, do të trajtojë me talent, guxim e thellësi fjale, me ngjyrë kontrastuese problemin e diskriminimit racial, një plagë që vazhdon 'të jetojë' edhe sot e kësaj dite, ndonëse shekujt i përcjellin njëri-tjetrin shpresën se, a do të ketë një ditë që bota t'i gëzohet një agimi fatlum mirësies, singjeriteti e barazie midis njerëzve...

Sa jetësor e i povdekshtëm është romanii "Aventurat e Tom Sojerit", po aq i tillë është dhe "Aventurat e Hakëlberi Finit", të cilët fituan një famë të përbotshme. Tueini dhe Tomi janë shpalim i një bote të bukur e plot aventura... Tueini është një qytetar guximtar, që me misionin fisnik të shkrimitarit zbulon rrënjet e së keqes. Flet troç e pa dorashka, pa iu trembur syri e pa iu dridhur qerpiku. Ky është dinjiteti artistik i këtij shkrimitari! Tomi dhe Tueini janë bashkëtarë: shkrimitar e personazh, ku në çdo hap të jetës 'takojnjë' vese të tilla, si këto: hipokrizia dhe mashtrimi. Dhe kujtonjë... dhe sjellin ndërmend se si bota e shoqëria njerëzore, do të vuajnë serialin e tragjedive të reja... Kjo është dhe arsyesa kryesore që Tueini lëvront këtë fushë (letërsinë përfëmijë) me aq pasion e dashuri. Nëpërmjet kësaj bote ku mund të veprojë i shpënguar, Tueini thurën e ndrrën e vet për një jetë më të pastër e më të mirë; ku fëmijërinë e Tomit plot çapëkënlëqe, bën që secili nga fëmijët ta përfjetojë nga pakëz gjatë leximit,

fëmijëri që nuk mund të venitet kurrrë.


Mark Tueini është nga ajo tipologji shkrimtarësh, me të cilin lexuesi ynë shqiptar ka hyrë në dialog që në fëmijërinë e tij, nëpërmjet romaneve të mrekullueshëm, si: "Aventurat e Tom Sojerit", e "Aventurat e Hakëlberi Finit", etj. KUJTESË e fëmijërisë, KUJTESË e ripërsëritjes së fëmijërisë, K U J T E S

É... Mark Tueini, romanin "Aventurat e Tom Sojerit" e shkroi në vitin 1876 (në shqip u botua në vitin 1955, përkthyer nga rusishtja Bedri Dedja; 1990, 1998 "Mësonjëtorja", përktheu nga anglishtja Ardian Klosi); kur romanin "Aventurat e Hakëlberi Finit" e shkroi në vitin 1884 (në shqip u botua në vitet 1957, 1976, 1998 "Phenix", përktheu Gjergj Zheji).

Të dy romanet janë të lidhur me njëri-tjetrin, sepse dy personazhet kryesorë Tomi dhe H(a)ekeli janë shokë. Këta dy fëmijë janë të lidhur me njëri-tjetrin për kokë dhe së bashku kryejnë shumë aksione të guximshme. Janë fëmijë të shkathët e të zgjuar, zemërbardhë dhe éndërrimtarë. Tomi ka një fantazi shumë të zhvilluar, sepse lexon libra. Kur H(a)ekeli jetim jeton thaujse në mëshirën e fatit, sepse babanë e tij e ka shkatërruar plotësisht shoqëria e kohës, duke e kthyer në një pijnac.

"Aventurat e Hakëlberi Finit" është një vepër ku gjen pasqyrim "ndërgjegjja" e një epoke, të mbrijtjurt me kontradiktë dhe, përmë tepër, të rëndësishme, sepse përbën rrënjet mbi të cilat ka hedhur shtat gjithë atë sistem tiparesh morale dhe etike i Amerikës së sotme.

Që te "Aventurat e Tom Sojerit", Tueini arriti dikça thua se të paparë te ai vetë në të kaluarën dhe në përgjithësi në letërsinë amerikane - ai e përdori humorin, për të cilin ai shquhet aq shumë, si mjet për shtjellimin realist të psikologjisë së njeriut (para së gjithash, të fëmijëve) dhe njëkohësisht si mjet për poetizimin e jetës. Me një vërtetësi të përkryer, ai riprodhon botën e brendshme të qenieve të njoma njerëzore që ende s'e kanë humbur pastërtinë shpirtërore dhe bukurinë poetike. Por vetëm me romanin e tij "Aventurat e Hakëlberi Finit" ai arriti të sigurojë atë vendi, që e bën atë, krahas Uolit Utman, themelues të letërsisë së re realiste amerikane.



NUMRI I ARDHSHËM MË 10 QERSHOR

HEJZA

01 QERSHOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000